
Vesë
Viti 4 • Numri 15 • Korrik - Shtator 2016
Dhuratë e revistës Etika
لَبَّيْكَ اَللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ،
إِنَّ الْحَمْدَ وَالنِّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ.
Zemra
e Botës...

PROGRESI
BOTIME

Shtëpia botuese Progresi vjen me 6 libra të rinj, të cilët do të ushqejnë botën tonë shpirtërore dhe do t'i japin drejtim jetës sonë individuale dhe shoqërore.

TË RINJ

Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro

Një këshillë
1001 mësime
350 Lekë
3 Euro

101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro

Shqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro

Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: rev.etika@gmail.com
KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848
MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Çdo njeri është një botë e vogël... Damarët tanë ngjajnë me lumenjtë e tokës; flokët ngjajnë me pemët dhe barin... Ashtu siç malet janë të ngulura në tokë, ashtu janë edhe kockat tona, ato janë skeleti që mban drejt trupin tonë... Një trup i tillë ka nevojë për një zemër, ndërsa zemra e botës është Qabja...

Njerëzit që lënë vendin e tyre për t'u nisur drejt këtij udhëtimi, në fakt nisen drejt një udhëtimi në zemrën e tyre. Hapi i parë i këtij udhëtimi është durimi... Që nga fillimi i përgatitjeve të këtij udhëtimi dhe deri në fund të tij duhet të tregohemi të durueshëm!.. Le të bëjmë durim gjatë përgatitjeve, le të jemi të durueshëm kur zbulojmë gjërat që kemi harruar, le të tregohemi të duruar me shoqëruesit tanë gjatë udhëtimit, le të jemi të duruar me kushtet që gjejmë në vendin ku shkojmë, edhe nëse ato nuk janë ashtu siç i prisnim, le të tregohemi të duruar me pengesat që na dalin përpara teksa jemi duke kryer adhurimet tona, le të jemi të durueshëm ndaj sëmundjeve, lodhjes, mungesës së njohurive e shumë gjërave të tjera... Durim teksa kryejmë adhurimet... Një nga adhurimet më të mëdha është dhënia ndihmë të tjerëve dhe në veçanti gjatë këtyre veprimeve duhet të tregohemi të duruar...

Hapi i dytë i këtij udhëtimi është nënshtrimi... Një nënshtrim i ngjashëm me atë të Haxherit, që eci me mijëra kilometra me Ismailin në krahë... Një nënshtrim i ngjashëm me atë të nënës sonë Haxher, që edhe kur kishte mbetur pa ushqime dhe pa ujë nuk e humbi shpresën... Nënshtrimin që tregoi Ibrahimi teksa largohej duke lënë pas gruan dhe birin e tij të dashur...

Hapi kryesor i këtij udhëtimi është: "Vënia në qendër e Allahut dhe përkushtimi për të plotësuar urdhrat e Tij..."

Le të pohojmë me sinqeritet të plotë se ne jemi njerëz të pafuqishëm, kurse Ai është Zoti ynë i plotfuqishëm...

Hapi i fundit i këtij udhëtimi është pendimi...

Streha nën të cilën gjetën shpëtim Ademi dhe Havaja... Pendimi është magneti hyjnor që kanë predikuar të gjithë profetët... Le të pendohemi për gabimet që kemi bërë, për gjërat që kemi harruar, për kryengritjet tona, për gjërat që kemi lënë mbas dore dhe për çdo të keqe që kemi bërë me dashje ose pa dashje... Le të pendohemi edhe për gabimet që kemi bërë teksa kemi kryer adhurimet tona...

BOTUESI
Shtëpia Botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Ernida Kraja | Naile Sulaj

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 340 6182

E-MAIL
rev.etika@gmail. com

VITI: IV
NUMRI: 15
Korrik-Shtator
2016

Përmbajtja

Kush vendos të kryejë Haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet 5
Fatma Hale Liman

Haxhi është një udhëtim që e bëjmë për të njohur veten 8
Fatma Nur Xhihan

Liria e vërtetë 11
Kybra Çoban

Të zgjohesh, të zgjosh të tjerët dhe të duash... 12
Aishegyl Ballta

Më fto edhe mua 14
Seher Ajdën

Brenda meje kishte pranverë... 15
Fatma Allada

Ishte shumë e bukur, vdekja nuk i shkonte 16
Halime Demireshik

Si konsiderohet femra në hebraizëm, krishtërim dhe injorancë? Si konsiderohet në Islam? 20
Osman Nuri Topbash

Përgatite zemrën tënde për Haxh dhe Umre 22
Zahide Topçu

Më merrni edhe mua... 23
Demet Çelik

Si quhesh? 24
Shefika Kaja Meriç

Nga duhet t'ia fillojmë 26
Fatma Bagan

Copëza lumturie 28
Ela Muça

Dhe Bajrami vjen... 29

Jetim si Profeti 30
Kevser Atar

Haxheri 32
Shule Sever

Mos i bëj padrejtësi jetimit!.. 35
Rukije Gënyly

KUSH VENDOS TË KRYEJË HAXHILLËKUN, LE TË LARGOHET NGA MARRËDHËNIET (ME GRUAN), GRINDJET DHE SHARJET

Fatma Hale Liman

Fytyra e vërtetë e një njeriu dallohet vetëm në umre dhe haxh. Çdokush në vendin e vet mund të vendosë maskën e dëshiruar, por në tokën e shenjtë nuk mundet të shtiret më. Çuditemi shumë kur shohim se njerëzit që na janë dukur shumë të edukuar në të vërtetë janë egoistë dhe të padurueshëm. Allahu (xh.sh.), bën që atje çdokush të na e tregojë fytyrën e vet të vërtetë. Karakterin e vërtetë të njeriut nuk mund ta fshehë as pasuria, as pronat dhe as karriera e tij.

"Haxhi është Arafat" ...Ashtu siç na ka mësuar Pejgamberi ynë, haxhi fillon me Arafatin së bashku me umren e bërë më përpara dhe vazhdon me Muzdelifen, goditjen me gurë të shejtanit në Mina, prerjen e kurbanit dhe përfundon me vizitën e fundit në Qabe.

Vizitorët e qyteteve të shenjta i bëjnë me shumë lehtësi të gjitha këto veprime. Njerëzit që kryejnë haxhin bëhen haxhinj. Njerëzit që kthehen nga haxhi quhen haxhinj nga të gjithë njerëzit e tjerë, por a quhen ashtu edhe nga melekët... Përgjigjja e kësaj pyetjeje është:

"Jo, melekët nuk janë të të njëjtit mendim!"

Nuk është e drejta jonë që të vendosim pranimin apo jo të adhurimeve të bëra. A shkruajnë edhe melekët se adhurimi ynë është i pranuar? Le të kujtojmë historinë e Abdullah bin Mubarekut:

Pasi kishte kryer detyrimet e tij të haxhit në Meke, Abdullah bin Mubarekun e kishte zënë gjumi në Harem. Shikon një ëndërr sikur dy melekë zbritën nga qielli. Ato po bisedonin me njëri- tjetrin:

"Këtë vit 600 njerëz bënë haxhin dhe asnjërit prej tyre nuk iu pranua, por për hatër të një vepre të bërë nga një këpucëtar i Shamit, i quajtur Ali bin Muvaffak, Allahu (xh.sh.), ua pranoi haxhin të gjithëve."

Abdullah bin Mubarek ishte shumë i habitur kur u zgjua. Vendosi të shkonte menjëherë pranë Ali bin Muvaffakut për t'u njohur me të. Pa humbur kohë shkoi në Sham dhe kur e gjeti atë, e pyeti:

"Si e bëre haxhin ti duke qenë se Allahu (xh.sh.), e pranoi haxhin e të gjithë njerëzve të tjerë vetëm për hatrin tënd?"

Ali bin Muvaffak iu përgjigj:

"Këtu ka një gabim. Unë bëra nijetin për të shkuar

në haxh, por nuk pata mundësi të shkoja."

Kur dëgjoi këtë përgjigje, Abdullah bin Mubarek u bë shumë kurioz dhe kërkoi ta mësonte të vërtetën e kësaj historie. Ali bin Mubareku filloi t'ia shpjegonte:

"Që prej tridhjetë vitesh ëndërroj që të shkoj në haxh. Gjatë kësaj periudhe me anë të zanatit tim kam mbledhur 300 dirhem. Bëra nijet për t'u nisur në haxh. Kishin mbetur pak ditë para nisjes për haxh, kur në shtëpinë tonë erdhi një erë mishi. Gruaja ime që ishte shtatzënë në atë periudhë më tha:

"Nga komshinjtë po vjen erë mishi, a mund t'u kërkosh atyre një copë mishi?"

Unë shkova tek komshiu im. Kur i tregova atij si ishte puna ai filloi të qante:

"Ky mish që jam duke gatuar është trupi i një kafshe të ngordhur që kam gjetur në rrugë. Ngrënia e një pjese të këtij mishi (sa për të mos vdekur) nga fëmijët e mi që kanë shtatë ditë pa ngrënë është hallall, kurse për ju është haram. Nëse nuk gjej dot një ushqim që është i lejuar do të detyrohem që t'ua jap këtë mish."

Ali bin Muvaffak vazhdoi:

"Fjalët e komshiut tim ma këputën shpirtin. Me lot në sy ia dhashë atij 300 dirhemët që i kisha mbledhur me aq vështirësi dhe i thashë: 'Ma bëj hallall sepse ti paske qenë i uritur dhe unë nuk kam ditur asgjë.'"

Pas kësaj Abdullah bin Mubarek e falënderoi Zotin që e mësoi këtë të vërtetë dhe e kuptoi se haxhi i është pranuar një njeriu që ka bërë nijet, por nuk ka shkuar fare në haxh.

Me të vërtetë që ashtu siç e ka shikuar në ëndërr Abdullah bin Mubarek, janë vetëm engjëjt që e kanë për detyrë të shënojnë njerëzit të cilëve u është pranuar haxhi që e dinë këtë çështje më mirë.

Vlera e veprave që bëhen në haxh nuk mund të matet në mënyrë shkencore. Mbase nuk kanë asnjë vlerë: 100 tavafe të bëra në Qabe, shumë e shumë umre të bëra, me mijëra rekate namazi të falura ... Në këtë mënyrë e kuptojmë se nuk janë të rëndësishëm numrat...

Haxhi dhe umreja janë adhurime të veçanta dhe të fshehta. Të dy këto adhurime kanë gjëra të qarta, por kanë edhe gjëra të fshehta. Ndryshimin mes këtyre gjërave e përcakton më shumë njeriu që i bën këto veprime.

Në vitin 2008, kur unë kam bërë umren kam takuar një grua shumë të edukuar. Kjo grua merrte për krahu plakat dhe i ndihmonte ato që të kryenin adhurimet e tyre. Ajo përpiqej shumë që ato plaka të mund të falnin namazin në Ravza, pastaj me zor falte dy rekat namaz para se pjesa ku faleshin gratë të mbyllej. Sigurisht që ajo kishte mundësi që të falte më shumë, të lexonte Kuran, të bënte dua, por kishte dëshirë që t'i ndihmonte ato gra të moshuara.

Unë në Medinë kam parë dhe bij të tillë që e çonin nënën e tyre një herë në Ravza dhe pastaj e linin në hotel që të mos u bëhej pengesë. Ai vetë falte namaze në Xhaminë Nebevi, lexonte Kuran, bënte tesbih, bënte adhurime të tjera. Nëna e tij priste të birin në hotel. Sipas jush, cili prej tyre ka fituar më shumë sevape? Ai që ka bërë më shumë adhurime apo ajo që ndihmoi më shumë njerëz dhe që fitoi duanë e të gjithëve?

Një grua tjetër që takova gjatë umresë më tha:

"Ne japim çdo gjë për të fituar një dua; 'Allahu ta shpërbleftë!"

Në Qabe tri gra erdhën pranë meje dhe më thanë:

"Një shoqe e jona na tha: 'Më pritni se po vij pas pak'. E kemi pritur katër orë pranë dritave të gjelbra dhe nuk ka ardhur akoma."

Pas pak kohe unë mësova se ajo u kishte thënë ashtu shoqeve të veta për t'u larguar prej tyre; ndërkohë ajo nuk kishte shkuar pranë tyre dhe kishte bërë disa tavafe. Shoqet e saj ishin pak të vjetra dhe, ngaqë nuk dinin të lexonin, i shkonin gjithkund nga pas shoqes së tyre të re, sepse kishin frikë se mos humbnin në mes të gjithë atyre njerëzve. Gruaja e re qenka lodhur nga shoqet e veta të cilat ishte e detyruar t'i shoqëronte gjithkund pa i mbetur kohë për të kryer adhurimet që kishte dëshirë dhe nuk kishte gjetur asnjë mënyrë tjetër vetëm duke i larguar ato. Pas asaj dite gratë ishin grindur shumë rëndë dhe i kishin mbajtur mëri.

Vetvetiu lind pyetja: "Si mundet njeriu të grindet në kohën që është në umre, në haxh?"

Siç ka thënë një njeri i ditur, Ali Ulvi Kuruxhu:

"Kryetari i shejtanëve ndodhet në Mekë dhe Medine."

Ne sikur jemi në një përpjekje të vazhdueshme për ta vërtetuar këtë fjalë, në atë tokë të shenjtë bëjmë gabime shumë të çuditshme dhe kapemi pas gjërave aq të parëndësishme sa habitemi.

Në haxh lind një ves i veçantë: "egoizmi në adhurim"... Kërkojmë të bëjmë sa më shumë adhurime dhe pa na shqetësuar askush:

"Dua të fal namaz në vendin ku Qabja duket më bukur";

"Dua të qëndroj pranë Gurit të zi, dua ta prek atë";

"Dua ta përqafoj mbulesën e Qabes dhe të bëj dua duke qarë";

"Dua të fal namaz në Hixhr";

"Ah sikur të mos kishte kaq shumë njerëz që bëjnë tavafin";

"Dua të futem e para në Ravza, në mënyrë që të zë vend në rreshtat e parë";

"Dua të falem në qetësi dhe e pashqetësuar nga askush";

"Sa mirë do të ishte sikur të mos më kërkonin që t'u liroja vendin."

Ka njerëz të cilët nuk kanë dëshirë të qëndrojnë me askënd, sepse kjo mund t'i pengojë. Këta njerëz bëjnë tavaf me nxitim dhe kur mbërrijnë në hotel fillojnë të krenohen për numrin e tavafeve të bëra... Sikur Allahu do të gjykojë numrat... Nuk e mendojnë faktin se ndihma që mund t'i jepnin miqve të tyre mund t'i bënte të fitonin më shumë sevape. Në këtë rast kemi një llogaritje të gabuar. Për Allahun nuk kanë rëndësi numrat, por sinqeriteti në kryerjen e një adhurimi... Llogaritë e këtyre njerëzve dalin gjithmonë gabim. Në dukje ata kryejnë shumë adhurime, por pa dashje thyejnë zemrat e shumë njerëzve dhe nuk bëjnë asnjë sakrificë prej të cilave do të fitonin një: "Allahu ta shpërbleftë!"

Një ditë ne ishim në Ravza kur shikova një grua të moshuar që po qëndronte jashtë duke i dërguar salavat Resulullahut. Kur e pyeta për shkakun e këtij veprimi, më tha:

"Gratë brenda po grihen me zë aq të lartë, sa shpirti i të Dërguarit është larguar prej aty për shkak të sjelljes së tyre të keqe..."

Pastaj na kujtoi ajetin:

"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare." (Huxhurat, 2)

Pas kësaj shtoi:

"Të mirat që bëjmë këtu po na ikin nga duart, unë po largohem!.."

Mevlana i nderuar na ka kujtuar:

"Nëse i çon Allahut trasta të mbushura me ar do të marrësh këtë përgjigje: 'Nëse dëshiron të Na sjellësh diçka, na sill një zemër të fituar! Nëse ndihma e zemrës që ke fituar është me ty, lumenj begatie do të rrjedhin.'"

Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet *(me gruan)*, ***grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!*** (Bekare, 197)

Në kohët normale, nëse mendojmë diçka të keqe por nuk e zbatojmë atë, nuk na kërkohet llogari për këtë vepër, por në kohën e haxhit dhe umres japim llogari edhe për një mendim të tillë. Nga ana tjetër, shpërblimi për një haxh apo një umre të kryer sipas rregullave dhe me sinqeritetin përkatës është shumë i madh.

Ka disa gra të cilat kanë fituar vlera shumë të mëdha gjatë haxhit ose umres dhe kanë fituar dashurinë e Zotit; një prej tyre më ka habitur shumë. Një grua e thjeshtë, që në dukje nuk kishte asgjë të veçantë më tha:

"Bija ime! A e shikon ujin e keutherit që gurgullon nën minberin (pjesën e ngritur të xhamisë ku mbahet hutbja) e Resulullahut! Ah sa bukur që buron!"

Më mrekulloi fakti që kjo grua e thjeshtë shikonte ato gjëra të mrekullueshme që ne njerëzit e tjerë nuk i shikonim dot. Sa i madh do të ishte mëkati i thyerjes së zemrës së një gruaje me shpirt kaq të lartë… Ne nuk mund ta dimë se kush na del përpara në Haxh dhe në umre. Nga mungesa e kujdesit tonë mund të mërziten njerëz shumë të dashur të Allahut dhe të gjitha veprat tona të mira të zhduken. Le të mendojmë se çdo njeri që takojmë në haxh apo në umre është një njeri i shenjtë. Nuk duhet të harrojmë se teksa ne bëjmë adhurimet tona, rreth nesh sillen njerëz të bekuar.

Allahu na bëftë nga njerëzit që e kuptojnë vlerën e haxhit dhe të umres dhe e kryejnë këtë adhurim ashtu siç duhet për të fituar shpërblimin e Allahut!

Fatma Nur Cihan

Haxhi është një udhëtim
që bëjmë për të njohur veten



Çdo njeri është një botë e vogël... Damarët tanë ngjajnë me lumenjtë e tokës; flokët ngjajnë me pemët dhe barin... Ashtu siç malet janë të ngulura në tokë, ashtu janë edhe kockat tona, ato janë skeleti që mban drejt trupin tonë... Një trup i tillë ka nevojë për një zemër, ndërsa zemra e botës është Qabja...

Njerëzit që lënë vendin e tyre për t'u nisur drejt këtij udhëtimi, në fakt nisen drejt një udhëtimi në zemrën e tyre. Hapi i parë i këtij udhëtimi është durimi... Që nga fillimi i përgatitjeve të këtij udhëtimi dhe deri në fund të tij duhet të tregohemi të durueshëm!.. Le të bëjmë durim gjatë përgatitjeve, le të jemi të durueshëm kur zbulojmë gjërat që kemi harruar, le të tregohemi të duruar me shoqëruesit tanë gjatë udhëtimit, le të jemi të duruar me kushtet që gjejmë në vendin ku shkojmë, edhe nëse ato nuk janë ashtu siç i prisnim, le të tregohemi të duruar me pengesat që na dalin përpara teksa jemi duke kryer adhurimet tona, le të jemi të durueshëm ndaj sëmundjeve, lodhjes, mungesës së njohurive e shumë gjërave të tjera... Durim teksa kryejmë adhurimet... Një nga adhurimet më të mëdha është dhënia ndihmë të tjerëve dhe në veçanti gjatë këtyre veprimeve duhet të tregohemi të duruar... Durim teksa presim në diell, ecim në ditët e nxehta, ngrihemi në të ftohtë, presim në trafik... Çdo gjë përfundoi, jemi duke u kthyer, jemi duke pritur autobusin ose avionin; përsëri le të bëjmë durim...

Hapi i dytë i këtij udhëtimi është nënshtrimi... Një nënshtrim i ngjashëm me atë të Haxherit, që eci me mijëra kilometra me Ismailin në krahë... Një nënshtrim i ngjashëm me atë të nënës sonë Haxher, që edhe kur kishte mbetur pa ushqime dhe pa ujë nuk e humbi shpresën dhe i lutej vetëm Allahut... Nënshtrimin që tregoi Ibrahimi

teksa largohej duke lënë pas gruan dhe birin e tij të dashur...

Një shembull tjetër nënshtrimi është ai i nënës sonë Haxher, që ia jep djalin e vet të rritur me aq shumë vështirësi Ibrahimit që do ta bënte kurban... Nënshtrimi i lartë i Ibrahimit që ishte gati të plotësonte urdhrin e Allahut dhe ta flijonte birin e vet të dashur... Nënshtrimi i tij në një moment të vështirë, teksa bëhet gati të flijojë të birin...

Hapi kryesor i këtij udhëtimi është: "Vënia në qendër e Allahut dhe përkushtimi për të plotësuar urdhrat e Tij..."

Në kohën që bëjmë tavafin dhe çdo adhurim tjetër duhet të harrojmë çdo gjë tjetër të kësaj bote dhe t'i përkushtohemi vetëm Krijuesit tonë...

Le të pohojmë me sinqeritet të plotë se ne jemi njerëz të pafuqishëm, kurse Ai është Zoti ynë i plotfuqishëm...

Në botë ka ditë dhe natë, ka dritë dhe errësirë; në të njëjtën mënyrë edhe brenda njeriut ekzistojnë përkushtimi dhe kryengritja. Teksa gjuajmë me gurë shejtanin duhet të bëjmë të njëjtën gjë me veset tona të këqija... Ashtu siç presim kurban për hir të Allahut, ashtu duhet të jemi gati të flijojmë çdo gjë tonën në rrugë të Tij. Zhdukja e plotë e egos është e pamundur, egoja do të jetë pranë nesh gjatë gjithë jetës sonë, por nuk mund ta lejojmë që të drejtojë jetën tonë, duhet ta nënshtrojmë atë. Duhet ta kontrollojmë egon tonë ose do të rrezikojmë që të shkojmë në rrugë të gabuar... Duhet t'ia kujtojmë gjithmonë faktin që e kemi në dorë... Le ta godasim me gurë atë dhe gjithë veset e këqija...

Arma më e fortë ndaj këtyre armiqve është duaja dhe sexhdja... Ajo është dera ku trokiti Ibrahimi kur i kërkonte Allahut një brez të drejtë... Është dera ku trokiti ai që kishte lënë të birin në mes të shkretëtirës... Është lutja që bëri të buronte uji i zemzemit në mes të shkretëtirës... Është përgjërimi i pranuar i Ibrahimit, i cili bëri të mundur që Pejgamberi i fundit i njerëzimit të rridhte nga brezi i tij...

Hapi i fundit i këtij udhëtimi është pendimi...

Streha nën të cilën gjetën shpëtim Ademi dhe Havaja... Pendimi është magneti hyjnor që kanë predikuar të gjithë profetët... Le të pendohemi për gabimet që kemi bërë, për gjërat që kemi

Resulullahu ka thënë:

"Ndaj atij, i cili ka mundësi financiare për të vizituar Shtëpinë e Zotit, e nuk e bën haxhin, nuk ka asnjë pengesë që ai të mos vdesë si çifut apo i krishterë"

(Tirmidhiu, Haxh, 3)

***

"Kush dëshiron të bëj haxhin le të nxitojë!"

(Xhemul Fevaid, II, 77)

***

"Njeriu që bën haxhin për hir të Allahut, në qoftë se nuk bie pre e egos (nefsit) së vet dhe nuk bën mëkate, do të pastrohet nga mëkatet dhe do të jetë i pastër si ditën që e ka lindur nëna."

(Në të gjithë librat e hadithit përveç Ebu Davudit)

***

"Ai që më viziton pas vdekjes sime është sikur të më kishte vizituar gjatë jetës sime!"

(Darkutni, Sunen, II, 278)

***

Gjatë vizitës së haxhit, Resulullahu, kur ka shikuar Shtëpinë e Zotit, ka ngritur duart dhe ka bërë këtë dua:

"O Allahu im! Rritja nderin, madhështinë dhe fisnikërinë kësaj Shtëpie. Shtoja nderin, madhështinë dhe fisnikërinë edhe njerëzve që e vizitojnë Atë në vizitën e haxhit dhe të umres."

(Ibn Sad, II, 173)

***

Në një hadith kudsi është porositur:

"Allahu (xh.sh.), ka thënë: 'Në qoftë se një rob, të cilit i kam dhënë shëndet dhe pasuri, nuk më viziton (pra nuk kryen umren apo haxhin) një herë në katër vjet, ai njeri është i mjerë."

(Hejthemi, III, 206.)

harruar, për kryengritjet tona, për gjërat që kemi lënë mbas dore dhe për çdo të keqe që kemi bërë me dashje ose pa dashje... Le të pendohemi edhe për gabimet që kemi bërë teksa kemi kryer adhurimet tona...

Rruga e nisur me durim përforcohet me nënshtrim, kurorëzohet me përkushtimin ndaj Allahut dhe pastrohet me dua dhe pendim. Në fund të këtij udhëtimi të vështirë ne jemi të pastër sikur kemi qenë ditën e parë që kemi hapur sytë në këtë botë. Jemi gati për t'u kthyer në vendet tona dhe themi:

"Ne e përfunduam me sukses udhëtimin tonë dhe tashmë nuk do t'i nënshtrohemi askujt tjetër përveç Allahut, nuk do të vjedhim, nuk do të bëjmë zina. Do të qëndrojmë larg interesit (interesi që merret bashkë me paratë e dhënë borxh) dhe gjakderdhjes. Nuk do të bëjmë thashetheme dhe nuk do të shpifim për njerëzit e tjerë; nuk do të përfitojmë nga prona e tjetrit. Do të jemi mbrojtësi i jetimëve, njerëzve të vetmuar, grave të veja dhe pleqve. Do ta ruajmë veten, familjen dhe shoqërinë tonë nga zjarri i Xhehenemit.

O Zoti ynë!.. Na ndihmo të mbajmë fjalën që të kemi dhënë!.. Mos na largo nga rruga e drejtë!.. O Zot, na ruaj nga të paudhët dhe mos lejo të jemi ndjekës të tyre!.. Na bëj bashkudhëtarë të profetëve, besnikëve dhe shehidëve!.. Ti je Zoti ynë dhe Mbrojtësi ynë...

Çfarë keni sjellë?

Një ditë drejtuesi shpirtëror i Pakistanit, Muhammed Ikbal pyeti udhëtarët që ktheheshin nga qyteti i Medines:

"Keni vizituar Medinën e Ndritur! Çfarë dhuratash shpirtërore keni marrë prej atje? Të gjitha dhuratat materiale që keni sjellë: shamitë, tespihet dhe sixhadet do të vjetrohen një ditë. A keni sjellë dhurata nga ato që nuk vjetrohen kurrë, që nuk vyshken kurrë?..

A ka mes dhuratave tuaja nga besnikëria dhe nënshtrimi i Ebu Bekrit; drejtësia e Omerit; modestia dhe bujaria e Osmanit; urtësia dhe trimëria e Aliut? A do të jenë në gjendje zemrat tuaja që t'i dhurojnë disa çaste qetësie kësaj bote islame që është e zhytur në vuajtje dhe hidhërim?"

Kybra Çoban

Liria e vërtetë

fitohet me skllavërinë ndaj Allahut (xh.sh.)

Kurban... Kur përmendet fjala kurban në mendjen tonë vjen dashuria, besimi, sakrifica, nënshtrimi, sprovat, përfitimi, begatia, porosia, liria... E thënë më shkurt, në mendjen tonë vjen Ibrahimi (a.s.).

Dashuria... Ibahimi (a.s.), e donte shumë birin e vet, por nuk donte askënd më shumë se Allahun. Ishte gati të bënte çdo gjë për Të. Ai pranoi të bënte kurban djalin e tij të dashur vetëm për hir të Allahut. Sa zgjedhje e vështirë që është, apo jo? Allahu në këtë mënyrë testoi dashurinë dhe nënshtrimin e tij. Pastaj i tha atij: "Miku im..." Për më tepër edhe Ismaili ishte gati të flijohej për hir të Allahut. Këta dy pejgamberë na dhanë një shembull të përsosur të dashurisë për Allahun (xh.sh.).

Besimi... Për Ibrahimin (a.s.), besimi që kishte për Allahun ishte më i rëndësishëm se çdo gjë tjetër. Kur vinte fjala për një urdhër të Allahut ai nuk mendonte: "a mund ta bëj unë", por "do ta bëj". Ai nuk pyeste arsyet apo qëllimet, sepse i besonte Zotit të vet me gjithë zemër, pa hezitime dhe dyshime.

Sakrifica... Ibrahimi (a.s.), hoqi dorë nga jeta e tij, u hodh në zjarrin e Nemrudit. Allahu (xh.sh.), e ktheu zjarrin në një kopsht me trëndafila. Ibrahimi u nda nga gruaja e tij, Haxherja dhe e la atë së bashku me djalin e vogël në Mekë. Më vonë Allahu i kërkoi atij që të flijonte të birin. Të gjitha këto ishin veprime që kërkonin sakrifica të mëdha. Ibrahimi i kaloi të gjitha këto prova me vendosmëri.

Nënshtrimi... Ibrahimi (a.s.), është një shembull i përkryer i nënshtrimit. Ai ishte i kënaqur nga çdo gjë që vinte nga Zoti i tij, edhe Zoti ishte i kënaqur me të. Ai u përul para çdo dëshire të Allahut dhe nuk e mendoi asnjëherë pyetjen: "O Allah, pse ma kërkove mua këtë gjë?"...

Sprovat... Ibrahimi (a.s.), jetoi një jetë të mbushur me sprova, ndoshta më e vështira nga këto ishte çasti kur do të bënte kurban të birin e dashur. Ai i kaloi të gjitha provat me sukses dhe fitoi vlera në detyrën e tij si rob i Allahut.

Përfitimi... Ibrahimi (a.s.), i zbatoi urdhrat e Allahut me përulësi dhe devotshmëri, prandaj ai është i fituar në këtë botë dhe në botën tjetër. Allahu nuk e braktisi asnjëherë, iu gjend pranë atij në momentet më të vështira. Në çastin kur ai po bënte kurban të birin, Allahu e zëvendësoi Ismailin (a.s.), me një dash; në çastin kur Ibrahimi (a.s.), u hodh në zjarr Allahu e ktheu atë në një kopsht me trëndafila... Fitorja më e madhe e Ibrahimit ishte dashuria e Allahut.

Begatia... Ibrahimi (a.s.), e jetoi çdo moment të jetës së tij me begatinë e të qenit i përulur. Edhe ne begatohemi me dashurinë e Allahut në momentin kur presim kurban vetëm për hir të Tij.

Amaneti... Pasuria jonë, jeta jonë, fëmijët tonë janë amaneti që Allahu na i ka besuar neve. Kur Allahu dëshiron të na e marrë një prej këtyre gjërave që i kemi dhuratë, ne duhet të jemi gati që t'ia japim me bindje të plotë, ashtu siç bëri Ibrahimi teksa bëhej gati të bënte kurban të birin.

Liria... Ibrahimi, alejhi selam, e fitoi lirinë teksa iu nënshtrua Allahut me gjithë qenien e vet, sepse liria e vërtetë fitohet me skllavërinë ndaj Allahut. Ai pejgamber i bekuar nuk kishte frikë nga asgjë dhe nga askush, sepse e kishte mbështetur shpinën tek Krijuesi i vet. Allahu nuk e la kurrë vetëm atë, prandaj Ibrahimi ishte i lirë. Ai çdo gjë e kërkonte prej Allahut, vetëm Atij i lutej, vetëm Atij i tregonte shqetësimet e veta. Nuk kërkonte asgjë prej askujt, prandaj ishte i lirë me kuptimin e vërtetë të fjalës.

O Allahu im! Na bëj edhe neve nga njerëzit që fitojnë lirinë e vërtetë, duke u bërë rob të denjë ndaj Teje. Bëj që ne të presim kurban me devotshmërinë e Ibrahimit, alejhi selam. Amin!

Ajshegyl Ballta

Të zgjohesh të zgjosh të tjerët dhe të duash...

"O vizitor i Mekes, për ku je nisur?"

"Ç'është kjo pyetje?"

"Pse pyet kur e di përgjigjen?"

Këtë pyetje në fillim ia bëj vetes pastaj ty: "Cili është qëllimi i vizitës tënde? Kë do të vizitosh? Pse po e bën këtë udhëtim?"

"Është shumë e qartë se unë po shkoj t'i bëj një vizitë Shtëpisë së Zotit."

Nuk po i bëj këto pyetje me qëllimin për t'i kërkuar llogari dikujt apo për të gjykuar dikë. Ju thashë dhe më përpara se këto fjalë që po shkruaj dalin nga thellësia e zemrës. Ky shkrim ka si qëllim që të nxjerrë në dritë mendimet tona të vërteta... Po shkruaj për t'u zgjuar, për t'ju zgjuar, për të jetuar me dashuri...

Këto fjalë po i shkruaj pasi kam kryer umren... Këtë herë përjetova ndjenja të ndryshme... ٥ vjet më përpara kam shkruar për herë të parë diçka për këtë temë. Kam shkruar me emocion për vendet e bekuara që kisha vizituar. Kisha shumë dëshirë t'i bëja një vizitë tjetër Medines së ndritur dhe Mekes së dashur, por këtë herë me ndjenja të tjera, me një emocion tjetër... Po shkoja dhe një herë në atdheun e njerëzve të vetmuar... Përdora këtë përcaktim, sepse çdokush që jeton larg këtyre vendeve të shenjta është i vetmuar dhe i mjerë...

Nëse qëllimi ynë ishte të bënim një vizitë në shtëpinë e Zotit, çfarë fituam prej kësaj; apo vetëm egoja jonë doli e fituar?

Egoja? Çfarë fitimi mund të ketë egoja jonë në ato vende të bekuara? Mos vallë nuk e di ti se sa hipokrite është egoja?! A nuk je njohur me atë fytyrë të saj që bën sikur po të afrohet me drejtësi dhe me qëllime të mira?!.. Egoja është ajo që na bën të qajmë kur lexojmë një material fetar të bukur dhe pastaj na i fshin nga zemra të gjitha ato që lexuam...

Po o udhëtar, edhe ti je gati për vizitë! Ke përgatitur rrobat e tua dhe je bërë gati për rrugë...

Për ku je nisur? A do të bësh një vizitë të udhëhequr nga pastërtia e shpirtit apo do të biesh rob i dëshirave të egos tënde? Sa bukur është të shikosh Meken dhe të bësh tavaf rreth saj! Mbase ke fatin që ta bësh shpesh këtë gjë, por mos harro se egoja po të vëzhgon

kudo dhe është gjithmonë në pritë për të të sulmuar. Duhet të jesh në gjendje që të thyesh idhujt dhe ta flijosh veten për hir të Allahut... O Zoti im, a kam fuqi unë që të nënshtroj veten dhe të bëj tavafin në mënyrën më të sinqertë të mundshme?

Ke shijuar bukuritë e papërsëritshme të Qabes? A është kënaqur zemra jote apo egoja?

Ç'është kjo pyetje?

Të kuptoj, e nderuar lexuese, i kuptoj shqetësimet e tua, por këtë herë zgjodha të shkruaj ndryshe, sepse mbase dikush nga ju do të më kuptojë...

Unë e di nga përvoja ime që është shumë e vështirë të mundet egoja, edhe kur jemi në tokat e shenjta.

Ja shikoje edhe vetë... Këtë vit ke ardhur sërish në këto toka të shenjta dhe vrapon për të falur namazet. Sa mirë!.. I falënderuar qoftë Zoti dhe uroj që të vazhdosh kështu... Ec drejt Ravzas e veshur me një rrobë të pastër e të zbukuruar... Je duke vështruar kupolën e gjelbër dhe sytë t'u mbushën me lot. Sa kënaqësi dhe përmallim të jep kjo pamje! Ti dëshiroje pastërti të shpirtit, por a nuk e shikon që përsëri egoja t'u paraqit para teje e zbukuruar...

Oh zemra ime! Oh nefsi im... Ma mbulove fytyrën me këto lot. Ti je si një vitrinë e bukur që maskon një dyqan me gjëra të shëmtuara.

Mos harro o udhëtar! Ti ke ardhur këtu për të shkatërruar idhujt e tu. Në qoftë se ti arrin të ecësh e lumtur në rrugët e Qabes teksa mban veshur një rrobë të thjeshtë, atëherë ti ke forcë për t'i luftuar këta idhuj. Me thjeshtësinë tënde i ngjan Pejgamberit tonë, atij që kishte zemrën më të pastër nga të gjithë njerëzit...

Deri në aksham je agjërueshëm... Në këtë të nxehtë ndizen gurët dhe vetë toka. Ty të është tharë goja... Ja, sapo këndoi ezani. Zemra jote qetësohet nga ezani që këndohet në Ravza e që përhapet në qiellin e Mekes. Ti fillon të hash iftarin. Rënkon e përmalluar teksa kujton Pejgamberin dhe sahabët. Përsëri gjithçka është në rregull, çdo gjë po ecën ashtu si duhet. Vallë, a do të ruash të njëjtën gjendje shpirtërore edhe kur të shkosh në hotel dhe të ulesh në një tavolinë të mbushur me gjellë nga më të ndryshmet? Si do të mund ta jetosh sunetin teksa qëndron në një vend ku ka shpërdorim të tepërt! Në qoftë se je e lumtur të bësh iftar me ullinj, djathë dhe bukë të thatë do të thotë se ti i ke rrëzuar idhujt e tu.

Thjeshtësia e rrobave dhe varfëria e sofrës duhet të të japë shumë kënaqësi, sepse vetëm atëherë mund ta kuptosh më mirë gjendjen e Resulullahut, vetëm atëherë do t'i ngjash atij më shumë. Po nëse ato ushqime i gjen të servirura në tavolinë, çfarë mund të bësh?! A të kujtohet se si po qaje pak më përpara?! Lotët të rridhnin nëpër faqe... Çfarë të ndodhi tani? Do të thotë se ti ke kënaqur egon tënde dhe jo shpirtin... Sa keq!...

Pak më tutje ndodhen vizitorët që vijnë nga Pakistani, India, Jemeni... Edhe ato kanë ardhur me të njëjtin qëllim si ti. Pse ecin ashtu zbathur? Çfarë është kjo metodë!.. Teksa po i shikoje ato sytë t'u fiksuan tek njollat e veshjeve të tyre!.. Pastaj fillove që të flisje në lidhje me këtë gjë me njerëzit përreth?! Ti i përbuz ato, por duhet ta dish se gjëja e vetme që meriton përbuzje është egoja jonë.

O udhëtar i Qabes, ti je një vizitor i Pejgamberit!... I Zoti i asaj Shtëpie i mirëpret ata... Sa të pavlera janë fjalët tona ndërkohë që i Zoti i Shtëpisë ua ka hapur krahët! Sytë e tu shqetësohen nga një njollë që shikon tek veshja e motrës/ vëllait tënd mysliman... Po veshja e shpirtit? A e shikon dot atë?! Zotësia e vërtetë është që ta mbash atë të pastër...

Ti thua se shqetësohesh nga era e keqe por mendo!.. Mendo për ato aroma të këqija që përhapen në zemrën tonë kur merremi me thashetheme! Si do t'i durojnë këto aroma të këqija melekët që ndodhen çdo çast pranë nesh?! Nënshtroje egon tënde o motër e dashur! Nënshtroje atë, që zemra të ketë mundësi të bëjë sexhde me modesti!

Çdo kulturë ka të veçantat e veta dhe mënyrën e vet të jetesës. Sikur të kishim lindur në ato vende edhe ne do të ishim të ngjashëm me ata njerëz. Ne kemi për detyrë vetëm që të bëjmë dua dhe të falënderojmë Allahun. Të zgjohesh, të zgjosh të tjerët dhe të duash!

Po ti o motër! Sa bukur qëndron! Ka kohë që po të shikoj me ëndje. Më pëlqen qetësia jote. Duhet të të përgëzojmë ty ashtu siç e meriton... Ke braktisur çdo gjë të kësaj bote dhe po pendohesh para Zotit tënd plot përkushtim! Ti po kthehesh prej këtu për të shkuar në vendin e njerëzve të vetmuar... Rruga të çon në vendin e njerëzve të vetmuar, por kthimi do të jetë për tek Zoti yt!

O udhëtar! Nisu për rrugë me qëllimin e flijimit të vetes për hir të Krijuesit! Shko atje për të thyer idhujt që ndodhen brenda shpirtit tënd. Shko për t'u kthyer! Shko për të pasur një kthim të mrekullueshëm! Shko atje për të kuptuar se cilat janë të metat dhe gabimet e tua; për të fshirë të shkuarën; për të mposhtur të keqen!

Le të jetë vajtja jote e mbushur me gabime mjafton që kthimi të jetë i bukur dhe i mrekullueshëm!

Seher Ajdën

Më fto edhe mua

Përsëri një stinë haxhi. Nga të katër anët e botës ka njerëz që i përgjigjen thirrjes së Ibrahimit (a.s.). Kjo thirrje i bëhet të gjithë njerëzimit, pa bërë ndarje mes shtresave shoqërore…

Haxhi është një mënyrë për të shlyer detyrimet që kemi ndaj Krijuesit të gjithësisë. Njerëzit të cilët kanë fatin të kryejnë këtë detyrë të shenjtë bëjnë udhëtimin më të begatë të jetës së tyre.

Pjesa tjetër e njerëzve luten me përgjërim. Akoma nuk ka ardhur asnjë ftesë për ata. Duatë e tyre njomen nga lotët e sinqertë. Ja se çfarë mërmërisin teksa si jetimë të shkretë përcjellin udhëtarët e haxhit:

Muajt, ditët, orët njomen me mall,

Vitet ndjekin njëri- tjetrin.

Nuk mund ta shpjegoj dot këtë ndjenjë,

Shembull i një dashurie që ka vite që pret…

Në një natë të tillë të mbushur me mall, një zemër e përmalluar i përgjërohet Allahut:

"O Krijuesi im Bujar! Ti më njeh mua më mirë se e njoh unë veten. Ti je dëshmitar i ditëve dhe netëve të mia; dashuria dhe malli që kam për Shtëpinë Tënde nuk përshkruhet dot. Nuk mjaftojnë fjalët për të shpjeguar këtë ndjenjë të zjarrtë… Ky mall po e ndez zemrën time… Çdo ditë që kalon nga jeta ime e shton këtë zjarr.

***

Shpirti im është robëruar në kraharor, nuk fluturon dot… Sa do të doja që të vinte ajo ftesë para se sytë e mi të mbylleshin dhe para se duart dhe këmbët të mbesin të palëvizshme… Ah sikur të vinte dhe të mund të digjesha në rërën e Ibrahimit… Ah sikur të bëhem Ismail dhe të flijohem… Ah sikur të bëhem Haxher dhe të ec kokulur në mes të shkretëtirës… Nuk dua të jem mysafir, por rob i Yti! Ah sikur të bëhem rëra që shkelin besimtarët që vizitojnë ato toka të shenjta!.. Ah sikur ta pastroja këtë fytyrë të ndotur me ujin e shenjtë të zemzemit…

Ah sikur të kisha mundësi të sillesha pa pushim rreth shtëpisë Tënde, derisa fryma të më mbaronte. Ah sa do të doja të sillesha derisa të bashkohesha me Ty. Të mos ngrihej koka ime nga sexhdja. Ashtu si nëna jonë Hava të vrapoja e shqetësuar drejt Arafatit dhe të përgjërohesha për falje derisa ta fitoja atë…

Ah sikur të mund të kisha shok rruge dikë si Ebu Bekri, dhe një shërbyes si Ali. Ah sikur ashtu si muhaxhirët të mos ndahesha asnjëherë nga Ai dhe ashtu si ensarët të jepja çdo gjë për Të…

Dua të puth vendet ku ka shkelur këmba e shenjtë e Resulullahut. Në Ravzan e shenjtë dua të ul kokën në sexhde dhe të falënderoj Allahun tim… Ah sikur t'i ngjaja Fatmas nga ana e moralit dhe Hatixhes nga ana e besnikërisë… Ah sikur të mund të përfitoja nga dituria e Aishes dhe nga modestia e Sevdes… Ah sikur t'u ngjaja atyre grave të ndritura.

O Krijuesi i çdo gjëje në mënyrën më të përsosur! Para se të më vijë vdekja më fto edhe mua!..

Falma Allada

Brenda meje kishte pranverë...

Bëj përpjekje që të zgjohem duke shijuar pikat e mëshirës. Rrezet e diellit sikur futen thellë në shpirtin tim dhe përpiqen të shkrijnë çdo gjë që gjejnë aty. Unë filloj të sillem në fushën e mbushur me lule; kjo është një dhuratë që më është bërë pas gjithë asaj errësire... Vetëm një melodi i shkon gjendjes sime shpirtërore... Marshi i ringjalljes...

Dikur isha e vdekur. Isha një kufomë që jetonte... Kisha një ngjyrë, por ishte pak e tepërt... Zemra ime nuk punonte në mënyrën e duhur. Kishte rregulla, e dija. Dëgjoja dhe mbaja shënime. Bota kishte një rregull jetese dhe unë bëja përpjekje për t'u përshtatur. Mendoja se ekzistonte një premtim i Zotit... Përveç kësaj, çfarë bëja unë?.. Zemra ime e cila nuk ishte bindur akoma trazohej dhe i harronte të gjitha rregullat, shtynte çdo gjë për më vonë dhe fshinte çdo gjë që kisha mësuar.

Më dukej sikur isha një myslimane e rregullt, por nuk i kryeja detyrat e mia si besimtare. Çdo gjë që bëja përfundonte në këtë botë; nuk punoja për botën tjetër...

I besoja dashurisë sime dhe asaj që mendoja se ishte e pastër: zemrës sime... Gjithmonë kisha pretekstin se ka njerëz që bëjnë të këqija shumë të mëdha, unë të paktën nuk isha e tillë, prandaj e meritoja mëshirën... Nuk e kuptoja se të gjitha këto justifikime më fishkëlleheshin në vesh nga shejtani. Nuk mbaronin kurrë këto fjalë... Unë, shejtani dhe egoja ime nuk ndaheshim dot; përkundrazi me kalimin e kohës ishim bërë më të bashkuar. Teksa ditët ecnin në këtë mënyrë e mira largohej nga unë dhe unë po njollosesha çdo ditë e më shumë.

Dëshiroja shumë që të zgjohesha një ditë dhe ta kuptoja se akoma nuk kisha vdekur, se zemra ime jetonte. Dëshiroja shumë që t'i hapja duart e mia të ndotura, t'i drejtoja drejt qiellit dhe plot përgjërim t'i lutesha Zotit të gjithësisë...

Ah sikur të mund të pastroja çdo qelizë të trupit tim, të merrja frymë me gjithë qenien time... Sa shumë e doja këtë gjë...

A duhet të ishte kaq e vështirë pritja e pranverës për të pastruar shpirtin... Çfarë duhet të bënte shpirti im i ndotur për t'u kthyer në gjendjen e tij fillestare?! Lutesha, e dëshiroja me gjithë shpirt këtë gjë... Shikoja qiellin me sy përgjërues...

...Unë bëja çdo përpjekje të mundshme për të mbledhur gjërat që do të më ndihmonin për këtë pastrim... Merrja abdest dhe falja namazin, pastaj për të qetësuar shpirtin tim të trazuar lexoja vargje që përshkruanin Zotin tim. Nuk isha lodhur duke bërë këtë pastrim... Plot emocion prisja pranverën prandaj isha ndryshe... Kjo pranverë do të sillte pak dhimbje, por unë nuk do të kurseja asgjë, do të bëja çdo gjë që duhej bërë... Dalëngadalë dhomat e errëta filluan të ndriçoheshin; nga zemra ime filluan të përhapeshin aroma të mira. Pranvera ishte shumë afër... Duhej shumë pak dhe unë do të kisha mundësi të hapja derën dhe t'i uroja mirëseardhjen pranverës...

Bëj përpjekje që të zgjohem duke shijuar pikat e mëshirës. Unë filloj të sillem në fushën e mbushur me lule; kjo është një dhuratë që më është bërë pas gjithë asaj errësire... Të gjitha dyert ishin të hapura, brenda meje kishte pranverë...

Halime Demireshik

Ishte shumë e bukur, VDEKJA nuk i shkonte

Vdekja na tregon se mund të vijë në çdo moment. Askush nuk shpëton prej saj, as i vjetri dhe as fëmija. Ajo vjen për të varfrin, por edhe për të pasurin... Ajo shkon tek njerëzit e sëmurë, por edhe tek ato që janë shëndoshë... Ajo mund t'ju vizitojë në çdo çast, por a jeni gati ju për ta pritur atë?

Vajza e re u zgjua nga zilja e telefonit. Kishte shumë gjumë dhe u ngrit gjithë përtesë.

"Kush më merr në pikë të sabahut?!"

Teksa mendonte ashtu shikoi se ora ishte 14:30 dhe u kujtua se natën e kaluar ishte kthyer në shtëpi në orën 2. Nuk arriti ta hapte telefonin. Pas disa minutash telefoni filloi të binte përsëri dhe këtë herë ajo u nervozua edhe më shumë. Filloi të kërkonte telefonin në çantë, por nuk e gjeti dot. I holli në tokë të gjitha gjërat e çantës dhe e hapi telefonin vetëm kur ai filloi të binte për të dhjetën herë.

Nga ana tjetër dëgjoheshin vetëm thirrje dhe të bërtitura. Nuk fliste askush. Vajza e shqetësuar pyeti:

"Alo, kush jeni ju?"

Erdhi një zë i mekur. Më në fund erdhi një përgjigje:

"Alo, jam Rejhana."

"Rejhana, çfarë ka ndodhur, pse po qan?"

"Amine!.. Mbrëmë, mbrëmë Fysunja ka bërë aksident. Tani sapo mësuam që ka vdekur. Hajde menjëherë!.."

Vajza tjetër e kishte mbyllur telefonin kurse Amina kishte mbetur e ngrirë me telefon në dorë. Po mendonte që një natë më përpara ato kishin qenë bashkë. Hëngrëm, pimë, u dëfryem, shkuam në kinema. Sa natë të bukur që kaluam të gjithë së bashku... Vajza që dje kishte qenë gjallë sot kishte vdekur?! Nuk mund ta pranonte dot.

"Nuk mund të ketë vdekur... Ajo ishte vetëm 19 vjeçe. Asaj nuk i shkon aspak vdekja.."

Pas pak erdhi në vete dhe filloi të bëhej gati. Po shkonte tek shtëpia e Fusunes. Duhet t'i kishin lajmëruar të gjitha shoqet e saj. Thirri një taksi dhe me nxitim u nis për tek shtëpia e së vdekurës. Këmbët që deri në atë çast po vraponin, kur iu afruan shtëpisë u ngulën në tokë. Nuk e gjente dot forcën për të ecur. E mbyste frika e përballjes me kufomën e shoqes së vet. Nuk donte ta pranonte, por gjëja më e tmerrshme për të ishte fakti që vdekja i kishte ardhur kaq afër.

Që në hyrje të apartamentit dëgjoheshin të qarat e njerëzve. Bëri një përpjekje për t'i dhënë forcë vetes. Filloi t'i ngjiste shkallët me ngadalë. I ra ziles. Atmosfera që mbizotëronte brenda u zbraz jashtë. Lot, rënkime, britma... Vajzat që kishin vendosur kokën në supet e njëra- tjetrës dhe që nuk dinin çfarë të bënin, ashtu të shtangura ishin tërhequr në një qoshe... Të gjitha vajzat e reja ishin mbledhur në një cep të dhomës. Asnjëra nuk fliste dot. Vetëm një natë më përpara kishin qenë së bashku. Më e reja dhe më e gjalla nga to ishte Fusunja... Buzëqeshjet dhe batutat e saj i jepnin gjallëri grupit... Tashmë mbi të ishte vendosur një mbulesë e bardhë. Rënkimi i nënës po tundte muret:

"Pse hodhe qefinin në një kohë kur do të vishje velin e bardhë?! Ngrihu, nuk të shkon kjo veshje... Është mëkat për rininë tënde, për bukurinë tënde!.."

Pak më vonë erdhën djemtë e familjes që e vendosën vajzën në tabut për ta nxjerr nga shtëpia. Tabuti mbërriti deri tek makina e xhenazes. Xhenazja do të dërgohej në xhami. Kishte një orë kohë derisa të këndohej ezani prandaj kishin thirrur një grua për të kënduar Mevlud.

Amina po qëndronte e vetmuar, duke menduar për gjërat që kishin ndodhur natën e kaluar. Ajo ishte futur në një botë tjetër dhe nuk e kishte vënë re gruan e nderuar që kishte filluar të fliste. Atë e kishin thirrur për të kënduar mevlud, por ajo kishte dashur të fliste pak pastaj kishte filluar të lexonte Kuran.

Amina nuk u përmend deri në momentin kur filloi të lexohej Kurani. Kurani ia qetësoi shpirtin, por gjithsesi brenda saj kishte një furtunë. Pse vdiq pikërisht ajo?! Ajo ishte e re, e bukur, ishte në pranverën e moshës së vet; a nuk mund të vdiste dikush tjetër... Ato do të jetonin shumë gjëra të bukura bashkë, pse vdiq? Nuk arrinte t'u jepte përgjigje këtyre pyetjeve. Filloi të kishte dhimbje koke nga këto mendime.

Leximi i Kuranit kishte mbaruar, tashmë filloi sohbeti. Në fillim ngushëlloi të afërmit e viktimës pastaj vazhdoi:

"Të dashur miq, Fusun ishte kushëririë edhe e imja. Ishte vajza ime e xhaxhait. Lotët dhe dhimbja jonë nuk mund të na e risjellin atë. Ajo është nisur për një rrugë që nuk ka kthim. Në qoftë se dëshirojmë t'i bëjmë mirë asaj, le të lexojmë Kuran për të dhe të japim lëmoshë. Tashmë ajo e ka mbyllur perden e kësaj bote. Mbase do të na vijë radha edhe neve. Ajo na flet me vdekjen e saj, por a mund ta dëgjojmë ne atë? A do të mund ta dëgjojmë heshtjen e saj?

Vdekja na tregon se mund të vijë në çdo moment. Askush nuk shpëton prej saj, as i vjetri dhe as fëmija. Ajo vjen për të varfrin, por edhe për të pasurin... Ajo shkon tek njerëzit e sëmurë, por edhe tek ato që janë shëndoshë... Ajo mund t'ju vizitojë në çdo çast, por a jeni gati ju për ta pritur atë?

Njerëzit që dëgjuan këto fjalë shikuan njëri- tjetrin në fillim, pastaj ulën kokat. Thirrjet kishin pushuar, shtëpia ishte bërë më e qetë...

Zemra e Amines ishte shumë e trazuar. Po sikur të kishte vdekur ajo vetë dhe jo shoqja e saj? Kur do ta vizitonte vdekja, e cila i kishte marrë shoqen? Po sikur të vdiste edhe ajo vetë në një moshë të re? Në qoftë se ndodhte një gjë e tillë, do të shkatërroheshin të gjitha planet e saj për të ardhmen, të gjitha ëndrrat. Çfarë kishte ndodhur me ëndrrat e shoqes së saj që kishte vdekur natën e kaluar? Sa prej qëllimeve të saj i kishte realizuar? Teksa ishte e zënë me mendimet e veta dëgjoi një zë:

"Unë kam shumë frikë nga vdekja, nuk dua të vdes!.."

Në atë moment sytë e çdokujt u sollën nga ana që erdhi zëri dhe të gjithë tundën kokën në shenjë pohimi. Të gjithë ishin të frikësuar nga vdekja.

Gruaja që po mbante sohbetin vendosi ta vazhdonte në këtë mënyrë fjalën e vet:

"Mevlana i nderuar ka thënë:

'Vdekja e secilit prej nesh është e ndryshme dhe e veçantë. Njerëzve që e urrejnë vdekjen ajo u vjen si një armik i frikshëm, kurse atyre që e duan u vjen si një mik i mirë.

O shpirt që ke frikë nga vdekja! Në qoftë se dëshiron të dish të vërtetën, pranoje se ti nuk ke frikë nga vdekja, por nga vetja jote.

Ajo që ty të shfaqet si vdekje e frikshme nuk është asgjë tjetër veç shëmtisë tënde. Shpirti yt i ngjan një peme. Vdekja është një gjethe prej saj. Përbërja e çdo gjethi varet nga pema në të cilën ndodhet.'

Nga kjo kuptojmë se vdekja është e frikshme vetëm për njerëzit që e harrojnë atë dhe që nuk bëjnë përgatitjet e duhura. Njerëzve që e kujtojnë çdo çast atë, vdekja u vjen si një mik. Një nga sababët e Resulullahut e ka pyetur Atë:

"O i Dërguari i Allahut!.. Cili është me i virtytshmi i besimtarëve?"

Pejgamberi ynë i nderuar i është përgjigjur:

"Ai i cili ka moralin më të lartë!"

"Po më i zgjuari i njerëzve, cili është?"

"Më i zgjuari i njerëzve është ai i cili e kujton shpesh vdekjen e tij dhe përgatitet për të. Këta janë njerëz me të vërtetë të zgjuar." (Ibn Maxhe, Zuhd, 31.)

Nga ky hadith kuptojmë se njerëzit duhet të bëjnë përgatitje për ditën kur do t'u vijë vdekja, sepse askush nuk shpëton prej saj. Herët apo vonë ajo vjen edhe për ne... Askush nuk ka shpëtuar nga vdekja dhe askush nuk është kthyer pas vdekjes.

Gruaja e nderuar e mbaroi tregimin e saj dhe lexoi një pjese të shkurtër nga mevludi. Njerëzit e shtëpisë filluan të bënin përgatitjet e vazhdimit të ritualit të xhenazes.

Amina kishte mbetur si e ngrirë. Sytë shikonin vendin ku pak më parë po qëndronte trupi i pajetë i shoqes së vet. U përmend vetëm kur vuri re që shoqet po e mbanin nga krahët në përpjekje për ta nxjerrë nga dhoma. Së bashku me shoqet u fut në makinë dhe po shkonin drejt varrezave. Ajo vazhdonte të mendonte... Unë gjatë gjithë jetës jam përgatitur për diçka. Për një drekë që do të zgjaste vetëm një gjysmë ore kam bërë përgatitje me orë të tëra në kuzhinë. Me vite të tëra kam shkuar në kurse për të dalë sa më mirë në provimin e universitetit. Dje para se të shkoja në kinema kam qëndruar me orë të tëra para pasqyrës për të zgjedhur veshjen. Po a jam përgatitur unë për vdekjen? Disa nga shoqet e mia falen, disa të tjera (si unë) vetëm agjërojnë, një herë në vit. Po tjetër? Kur isha e vogël, gjatë verës kam shkuar në xhami për të mësuar leximin e Kuranit, por më vonë nuk m'u krijua mundësia që t'i përsëris njohuritë që kisha marrë. Nuk i kam ngjarë aspak motrës sime. Ajo është e mbuluar dhe e fal namazin rregullisht. Por nuk është aspak e lehtë që ta bësh këtë... Unë kam një stil tjetër jetese, kam miq... Unë kam përfunduar shkollën dhe vajzat e mbuluara e kanë shumë të vështirë që të gjejnë punë. Mbulesa nuk është diçka që i përshtatet karakterit tim...

Në të vërtetë që nuk mund ta mendonte Fusunen së bashku me vdekjen. Shoqja e saj ishte plot jetë, sikur nuk do të vdiste kurrë. Vdekja mund t'i shkonte njerëzve të vjetër ose të sëmurë por jo shoqes së saj.

Kishin mbërritur në varreza. Arkivoli nuk kishte ardhur akoma. Ato

"Më i zgjuari i njerëzve është ai i cili e kujton shpesh vdekjen e tij dhe përgatitet për të. Këta janë njerëz me të vërtetë të zgjuar."

(Ibn Maxhe, Zuhd, 31)

filluan të prisnin tek një qoshe. Amina shikoi varrin me bisht të syrit. Tashmë kjo do të ishte shtëpia e re e shoqes së saj dhe njerëzit e tjerë të varrosur do të ishin miqtë e saj të ri... Shoqja e saj që sot do të qëndronte këtu, apo jo? Për një çast u dridh, i ftohti i tokës iu fut deri në palcë... Po afronte pranvera dhe toka ishte e lagur. Kishte disa ditë që shiu nuk pushonte... Sot do ta linin shoqen e saj të bukur në varr dhe do të largoheshin. Të gjithë do të vazhdonin jetën sikur nuk kishte ndodhur asgjë.

"Jeta është shumë e çuditshme..."- mendoi...

Askush nuk e donte aq shumë sa të qëndronte me të në varr, edhe nëna e saj do të largohej duke rënkuar... Sa keq... Shumë keq...

Amina shikoi gruan që u kishte folur sot para varrimit. Në kokë kishte shumë pyetje, prandaj mendoi të shkonte pranë saj dhe t'i kërkonte ndihmë. Iu afrua dhe i tha:

"Në qoftë se keni mundësi, do të doja t'ju pyesja për diçka."

Ajo e shikoi që Amina ishte shumë e menduar dhe i tha:

"Kemi disa minuta kohë derisa të mbërrijë xhenazja, urdhëro po të dëgjoj."

"Pse Fusun? Ajo ishte shumë e re, plot jetë. Pse jo një e moshuar por ajo?"

"Si fillim mund të them se vdekja është për të gjithë... Çdo njeri që në momentin që lind është kandidat i vdekjes... Disa prej nesh vdesin që në bark të nënës pa dalë në jetë. Vdekja nuk ka moshë. Askush nuk e di se kur dhe si do të vdesë, prandaj duhet të jemi të përgatitur për vdekjen, kurdo që ajo të vijë. Ti pyete arsyen pse vdekja u vjen edhe të rinjve dhe fëmijëve; sipas mendimit tim kjo është për të na kujtuar neve se vdekja mund të na vijë papritur. Në këtë mënyrë njerëzit e kuptojnë se duhet të jenë të përgatitur çdo çast, sepse vdekja nuk vjen vetëm në pleqëri. Njeriu jeton në dy mënyra: ose duke kryer detyrat fetare ose duke mëkatuar... Njerëzit që rininë e kanë të mbushur me adhurime vdesin të pastër dhe pa mëkate. Njerëzit që e kanë kaluar rininë me mëkate dhe vdesin të rinj kalojnë në botën e përtejme pa kryer edhe më shumë mëkate. Gjithsesi, ne të gjithë e pranojmë se vdekja e njerëzve të rinj është gjithmonë e vështirë. Junus Emre ka thënë:

Njerëzit që e braktisin këtë botë gënjeshtare,
Nuk na tregojnë asgjë, nuk na sjellin asnjë lajm!..
Njerëzit mbi të cilët mbin bari,
Nuk na tregojnë asgjë, nuk na sjellin asnjë lajm!..
Në varr të disa prej tyre lindin fidanë,
Në varrin e dikujt tjetër ka lule,
Varri i një tjetri mbushet me bar,
Njerëz të pafajshëm dhe trima,
Nuk na tregojnë asgjë, nuk na sjellin asnjë lajm!..
Trupat e tyre janë zhytur thellë në tokë,
Fjalët e tyre janë ngrirë në kohë,
Nuk harrohen në dua,
Nuk na tregojnë asgjë, nuk na sjellin asnjë lajm!..

Dikush është katër e dikush pesë,
Dikush nuk ka kurorë në kokë,
Nuk na tregojnë asgjë, nuk na sjellin asnjë lajm!..
Dikush është gjashtë vjeç e dikush shtatë,
Nuk na tregojnë asgjë, nuk na sjellin asnjë lajm!..
Dikush është tregtar e dikush mësues,
Të gjithë e kanë shijuar vdekjen!
Dikush është plak, dikush djalë i ri
Nuk na tregojnë asgjë, nuk na sjellin asnjë lajm!..
Ja shikoje se çfarë është kaderi
Shiko qerpikët që kanë rënë
Kokat e shpërfytyruara
Nuk na tregojnë asgjë, nuk na sjellin asnjë lajm!..

Nga këto vargje kuptojmë që njeriu duhet të bëjë përgatitje për vdekjen që në momentin kur fillon të mendojë.

Amina nga njëra anë dëgjonte gruan që po u jepte përgjigje pyetjeve të saj dhe nga ana tjetër vëzhgonte gurët e varrit.

vazhdon...

Osman Nuri Topbash

Si konsiderohet femra në hebraizëm, krishterim dhe injorancë? Si konsiderohet në Islam?

Njëshmëria dhe të qenit i Vetëm, i takon vetëm Allahut.

Nisur nga kjo, Allahu i Madhëruar ka krijuar gjithçka në çift. Tek njerëzit, bimët dhe kafshët kjo shfaqet në formën mashkull-femër. Ndërsa në krijesat jo të gjalla, shfaqet si plus (+) dhe minus (-). Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik flitet në ajete të ndryshme:

"Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin!" (Dharijat, 49)

"Qoftë lavdëruar Ai që i ka krijuar çift të gjitha llojet: çka mbin prej tokës, ata vetë dhe ato që nuk i dinë!" (Jasin, 36)

Të gjitha krijesat kanë nevojë për njëra-tjetrën nga aspekti i kësaj veçorie të të qenit çift, sepse një cilësi që ndodhet tek njëra, nuk ndodhet tek tjetra. Të gjitha formojnë një të vetme duke plotësuar njëra-tjetrën. Po ashtu, edhe për njeriun vlen e njëjta urtësi e të qenit mashkull-femër. Në një hadith fisnik, urdhërohet:

"Gratë janë gjysma tjetër e burrave." (Ebu Daud, Taha-ret, 94; Tirmidhi, Taharet, 82.)

Mirëpo, këto dy gjysma të së vërtetës njerëzore zotërojnë cilësi të veçanta, njësoj si polet plus dhe minus. Allahu i Madhëruar dëshiron që besimi, punët e mira, morali i bukur, pra devotshmëria, të jetë tek të gjithë meshkujt dhe femrat. Mirëpo, në lidhje me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë, të dyja gjinive u janë dhënë pika të veçanta për secilin prej tyre. Ashtu siç i ka bërë të ndryshëm në krijim, Allahu i ka bërë të ndryshëm edhe në të drejta dhe përgjegjësi.

Në përgjithësi:

Për shkak se meshkujt janë të fuqishëm, ndërsa femrat janë delikate, gjatë gjithë historisë, në shoqëritë ku ka mbizotëruar padrejtësia dhe injoranca, femra është shtypur.

Në kohën tonë, për të tërhequr vëmendjen ndaj padrejtësive që u bëhen grave, bota ka vendosur një ditë të veçantë:

8 Marsi Dita botërore e grave...

A është rastësi që një ditë e tillë është vendosur në perëndim?

Jo!..

E shkuara dhe e sotmja e Evropës, në përgjithësi e gjithë perëndimit, është e mbushur me probleme dhe fatkeqësi në lidhje me çështjen e gruas. Tek ata ekziston një botëkuptim i tillë ndaj gruas, që dje buronte prej besëtytnive, ndërsa sot prej dëshirave të epshit dhe mungesës së mëshirës, duke u sjellë midis fanatizmit dhe liberalizmit të tepruar pa e gjetur kurrë rrugën e mesme...

Më parë le të shohim të djeshmen:

GRUAJA NË SYTË E ITHTARËVE TË LIBRIT TË SHTREMBËRUAR. LODRA E SHEJTANIT

Burimi i perëndimit, është Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re, të cilat janë shtrembëruar. Pra, Hebraizmi dhe Krishterimi...

Gjurmët e shtrembërimit tek ata mund t'i vëresh edhe në shikimet e tyre përçmuese.

Ata e përçmojnë aq shumë gruan, saqë sipas Talmudit, një mashkull hebre sapo ngrihet në mëngjes:

"Duhet të falënderojë Zotin, për shkak se Ai e bëri pjesëtar të Bijve të Izraelit, nuk e krijoi si grua dhe nuk e bëri prej injorantëve/idhujtarëve..." (Menahot, 43b.; A. Cohen, Le Talmud, përkth. Jacques Marty, Paris 1991, fq. 211.) (Talmudi është shpjeguesi i Teuratit)

Përse të jesh grua, tregohet si një fatkeqësi sikur të jesh idhujtar?

Sepse në librin e shtrembëruar, të gjitha të këqijat i atribuohen femrës. Ajo, shihet dhe tregohet si, "hileqare, mashtruese, dinake, trilluese, burim i së keqes, mendjemadhe, e dhënë pas epshit, amorale, grindëse,

e papërgjegjshme dhe e prirë për idhujtari dhe besime të kota". (shih. Mbretërit I. 21/8, 25; Mbretërit II 9/30-37, 23/7, Numrat 31/15-16...)

Në këto tekste gjenden shprehje të tilla që e poshtërojnë femrën:

"Gruaja budallaqe është zhurmëmadhe, aspak e zgjuar dhe nuk di asgjë." (Fjalët e urta, 9/13.)

"Dhe gjeta një gjë më të hidhur se vdekja; gruan zemra e së cilës është kurth dhe grackë dhe duart e së cilës janë pranga. Kush i pëlqen Perëndisë i shpëton asaj; por mëkatari do të kapet nga ajo." (Predikuesit, 7/26.)

E vetmja rrugë që mund të jetë zgjidhje, pra edukimi i gruas, është prerë. Në fakt, gruaja jo vetëm që nuk merr pjesë në shumë adhurime, por vajzave u është ndaluar arsimimi dhe në mënyrë të veçantë marrja e dijeve fetare (për shkak se mund ta shtrembërojnë Teuratin). (shih. Talmud Bavli, shevouth, 42a, Baba Kama, 106b, Jevamot, 88b, Sotah, 20a.)

E njëjta konsideratë për femrën vazhdoi edhe në librin e shtrembëruar të krishterëve:

Femra u konsiderua si një krijesë më e ulët se mashkulli. Pali mendon se femra është një shkallë më poshtë mashkullit dhe shprehet:

"Burri nuk ka nevojë ta mbulojë kokën, sepse është shëmbëlltyra e lavdisë së Hyjit; ndërsa gruaja është nderi i burrit. Sepse nuk është burri prej gruas, por gruaja prej burrit. Dhe burri nuk u krijua për arsye të gruas, por gruaja për arsye të burrit. Prandaj, gruaja duhet ta mbajë mbi kokë shenjën e "vartësisë", për shkak të engjëjve." (I. e Korintasve, 11/7-10; shih. I. e Timoteut, 2/11-12.)

Sipas klerikëve fetarë të krishterë, gruaja është ajo që e çmend burrin, që e thërret atë në mëkat dhe që për këtë është një lodër e pistë e shejtanit, së cilës i duhet qëndruar larg. Ja pra, për shkak se gruaja konsiderohet një krijesë e pistë, klasa a murgjve e ka zgjedhur beqarinë si modelin e jetës më ideale.

Baballarët më të rëndësishëm të kishës, që orientojnë Krishterimin, shprehen:

Tertuliani (v. 220), thotë:

"Grua! Ti gjithmonë duhet të jesh e leckosur dhe në zi. Sytë e tu duhet të jenë plot me lot dhe shikimet e tua duhet të tregojnë pendim, me qëllim që të bësh të harrohet se ti e shkatërrove racën njerëzore. Grua! Ti je dera e ferrit! Edhe nëse raca njerëzore do të shuhej, ata duhet të zgjedhin të mos martohen."

Shën Juan Chrysostome (v. 407) thotë:

"Ndër të gjitha kafshët e egra, nuk mund të gjeni më të dëmshme se gruaja."

Gjithashtu, Chrysostome, thotë:

"Gruaja, është një e keqe e domosdoshme, një bela e dëshiruar. Ajo është rreziku më i madh i shtëpisë dhe familjes. Ajo është një e dashur e pamoralshme edhe e paedukatë. Një fatkeqësi e zbukuruar dhe mashtruese."

Ndërsa San Augustine, i përshkruan gratë si të mbushura me të këqija, ziliqare, të pavendosura dhe burimi i të gjitha debateve, grindjeve dhe padrejtësive.

Ajo që fajësohej, ishte e gjithë gjinia femërore, e jo vetëm gratë e prishura e të shthurura... Ishte gruaja ajo që e ndoti njerëzimin në mëkat, që prej Havasë/Evës! Kjo shihet qartë edhe në lutjen që thuhet gjatë ceremonive të martesës në kishat katolike, të cilat përsëriten edhe sot e kësaj dite:

"Me mëkat kam rënë në barkun e nënës, mëkat ka bërë edhe nëna ime kur ka mbetur shtatzënë."

Nëse konsiderata për gruan, martesën dhe familjen është kështu, në Krishterim, "familja" është konceptuar si një institucion krimi, ndërsa "martesa" si një e metë. Madje, mosmartesa e meshkujve dhe e femrave dhe mbyllja e tyre në manastire duke u bërë murgj dhe murgesha, është diçka e lavdëruar në Krishterim. Edhe pse martesa është e pranuar, divorci është i ndaluar tek ata, qoftë edhe për raste të domosdoshme. Në këtë mënyrë, ata u kanë hapur derën të gjitha botëkuptimeve në kundërshtim me krijimin, si amoralitetit, homoseksualizmit, prostitucionit etj.

Kjo nuk mbaron me kaq:

Në botën e krishterë të mesjetës, gruaja dhe martesa u përbuzën aq shumë, saqë në Koncilin e tretë të Maconit më 585, u diskutua se a kishte shpirt apo jo gruaja.

Lidhur me këtë, në atë periudhë, gjendja e jetës sociale së gruas u përkeqësua edhe më shumë. Prej shekullit XII, në Evropë filloi gjuetia e magjistarëve dhe e shtrigave, ku me pretendimin se kanë lidhje me xhindët/demonët, shumë gra u dogjën në turrën e druve ose u mbytën në ujë.

Ndërkohë që Krishterimi e përçmonte kaq shumë femrën, në kundërshtim me veten, ai e paraqiste Merjemen/Marian si nënë të Zotit, ndërsa melekët, i pikturonin në formën e gruas. Nisur nga kjo, mund të themi se, Krishterimi është i ndërthurur me shumë paradokse.

Zahide Topxhu

PËRGATITE ZEMRËN TËNDE PËR HAXH DHE UMRE

Allahu çdo vit i fton njerëzit në haxh dhe umre. Kjo ftesë ka nisur me Ibrahimin dhe gjatë gjithë kohës njerëzit janë nisur në grupe drejt tokave të shenjta. Disa njerëz nuk kanë mundësi të shkojnë asnjëherë në haxh, disa të tjerë kanë fatin të shkojnë disa herë në haxh ose në umre.

Siç ndodh me çdo udhëtim edhe udhëtimi drejt Mekës dhe Medinës ka rregullat e veta të cilat duhet të ndiqen. Njerëzit të cilët bëjnë nijet për të vizituar këto toka të shenjta duhet ta dinë shumë mirë arsyen pse janë duke e bërë këtë gjë. Këto nuk janë vende që vizitohen me qëllime turistike apo për të blerë dhurata. Këto janë toka të shenjta të cilat i ka zgjedhur vetë Allahu (xh.sh.). Këtu ndodhen kujtimet e Ademit, Ibrahimit, Ismailit dhe shumë njerëzve të tjerë të shenjtë. Është një fatkeqësi e madhe që të mos i dish këto gjëra dhe të mos kuptosh se sa të bekuara janë ato toka.

Le të mos harrojmë që haxhi është një nga urdhrat e Zotit dhe një mundësi shumë e mirë për të larë gjynahet dhe për t'u pastruar prej tyre. Duhet bërë përpjekje që të mos e harxhojmë kohën me gjëra të parëndësishme por t'ia kushtojmë të gjithë energjinë tonë duave, leximit të Kuranit, faljes së namazit dhe adhurimeve të tjera.

Qëllimi kryesor i haxhit është të mos mërzitemi dhe të mos mërzitim askënd. Kur jemi atje duhet të kemi kujdes që të mos bëjmë asnjë veprim që mund të shqetësojë njerëzit që na rrethojnë pa marrë parasysh asgjë.

Muhamed Belhi, i habitur kishte thënë këto fjalë:

"Sa e çuditshme është!.. Po mendoj për një njeri i cili ka kaluar shumë vende dhe shumë vështirësi për të mbërritur në Qabe dhe habitem me të. Shikimi i Qabes është një nga ndjenjat më të bukura që mund të provojë një njeri... Pse vallë, njerëzit bien pre e egove të tyre dhe nuk i drejtohen Qabes! Qabja është një vend i bekuar dhe i veçantë."

Duhet të kemi parasysh që nganjëherë, edhe pse njerëzit na dëmtojnë padrejtësisht, është shumë e rëndësishme që të bëhet durim dhe të mos i lëndojmë ata.

Një njeri e kishte zënë gjumi në Medine dhe kur ishte zgjuar kishte menduar se dikush i kishte vjedhur një çantë të vogël që kishte me vete. Njeriu i cili kishte filluar të kërkonte çantën e vet ishte takuar me imamin Xhafer Sadik dhe i ishte sulur atij duke i thënë:

"Ti e ke vjedhur çantën time!.."

"Çfarë kishte në atë çantë?"- e kishte pyetur Xhafer Sadik.

"Kishte një mijë dinar."

Kur kishte dëgjuar këtë përgjigje, imami e kishte marrë burrin në shtëpinë e vet dhe i kishte dhënë një mijë dinar. Burri ishte kthyer në shtëpi, por ishte habitur shumë kur kishte shikuar se çantën të cilën e pandehte të vjedhur e kishte lënë në shtëpi. Menjëherë ishte drejtuar tek Xhafer Sadiku, i kishte kërkuar të falur dhe ishte përpjekur për t'ia kthyer paratë. Xhaferi nuk i kishte pranuar këto para dhe i kishte thënë:

"Unë nuk e marr mbrapsht diçka që e jap njëherë."

Qëllimi i haxhit nuk është qëndrimi në hotele të bukura dhe ngrënia e ushqimeve nga më të ndryshmet. Mbase nuk është e nevojshme që gjatë ditëve të kaluara në këto toka të shenjta të jetohet në kushte të vështira, por nuk mund të dalim të fituar në qoftë se nuk sakrifikojmë pak nga rehatia dhe gjumi ynë.

Vizita e Qabes dhe përfitimi prej saj është një çështje shpirtërore. Në bazë të qëllimit me të cilin shkohet atje përcaktohet edhe rruga që do të ndiqet dhe si rrjedhojë vjen edhe shpërblimi që do të merret. Jemi dëshmitarë që haxhi dhe umreja nuk janë të varur vetëm nga paraja, dhe ky udhëtim nuk bëhet vetëm me para. Shumë të pasur nuk e kanë pasur fatin që të shkelin në ato toka të shenjta, nga ana tjetër, shumë njerëz të varfër në dukje, por me zemër të pasur janë lumturuar me mundësinë e të vizituarit tokat e shenjta.

Demet Çelik

MË MERRNI EDHE MUA...

O ti udhëtar i bekuar që ke marrë rrugën drejt kësaj toke të bekuar, jam e sigurt se emocioni yt rritet teksa po i afrohesh destinacionit tënd. Ke shumë të drejtë, sepse ky nuk është një udhëtim si gjithë të tjerët. Ky është një udhëtim drejt sulltanit tonë të zemrave, Pejgamberit tonë të dashur...

O haxhilerë!.. E di që nuk më merrni dot fizikisht pranë jush, por të paktën merrni shpirtin tim... Më kujtoni edhe mua kur të jeni në ato toka të bekuara. Ju përgjërohem që të mos më harroni dhe të ma bëni këtë të mirë. Dua që dhe unë të përkulem para Sulltanit të Gjithësisë dhe t'i them:

"O sulltani i zemrës sime! Më mungon shumë dhe do të doja shumë që të vija të të vizitoja, por nuk kam mundësi. Në qoftë se ti më dhuron një ftesë të tillë unë mund të vij. Në qoftë se më pranon pranë teje kam shumë dëshirë që t'ju vizitoj juve në këtë moshë të re. Ne, ymeti yt, nuk duam që të ndahemi nga ti; as në këtë botë as në botën tjetër. Urojmë që të jemi të denjë për ndërmjetësimin tënd në botën tjetër. A do të më marrësh pranë teje?"

O motrat e mija! Kur të jeni pranë Qabes, ruani pak vend edhe për mua... Kam shumë dëshirë që ndërsa ju jeni duke bërë tavaf, mëshira dhe gëzimi të më mbështjellë edhe mua... Në çdo hap që hedh le të afrohem me Krijuesin tim... Le të lartësohem e fisnikërohem...

Teksa ju vizitoni vendet e Mekës së nderuar, dua të vij bashkë me ju në shpellën Theur... Le të kujtojmë të dytin e të dyve, Ebu Bekrin. Le të kujtojmë ata njerëz të bekuar që qëndruan për tri ditë në atë shpellë të mbushur me të fshehta... Çfarë nënshtrimi është ky, çfarë dashurie për Krijuesin... Le të freskohemi edhe ne nga ky shi i mëshirës që vazhdon që në kohën e tyre...

Kur të jeni mes kodrave të Safas dhe Merves kujtoni vrapimin e nënës sonë Haxherit për të kërkuar ndihmën e Allahut për hir të djalit të vet të vogël. Në të njëjtën kohë le të shpresojmë që edhe neve do të na shpëtojë mëshira e Allahut teksa jemi duke vrapuar majtas djathtas në mahsher. Ju lutem! Më merrni edhe mua në mesin tuaj kur te jeni duke ecur mes Safas dhe Merves...

Kur të gjuani me gurë shejtanin ju lutem gjuani me gurë edhe egon time! Ju përgjërohem!..

Kur të shkoni në shpellën e Hiras shikoni Sulltanin e botës me sytë e zemrës. Imagjinoni takimin e Resulullahut me Xhebrailin (a.s) dhe momentet kur është zbritur Kurani... Imagjinoni kënaqësinë që ndjente Resulullahu, (a.s.), kur zbriste nga shpella e dritës pas zbritjes së Kuranit... Mendoni për gjendjen shpirtërore të tij teksa shkonte për të ndriçuar jetën dhe zemrat e njerëzve... Ëndërroni sikur Xhebraili të fliste edhe me ne...

Kur të jeni duke prerë kurbanin, sakrifikoni edhe të gjitha dëshirat e egos suaj në rrugën e drejtë...

Mali i Arafatit... Ju përgjërohem që të mos më harroni dhe mua kur të jeni në atë mal të bekuar në të cilin falen gabimet, ku pranohen duatë dhe ku rrjedhin lotët si lumenjtë... Derdhni një pikë lot edhe për mua, ju lutem... Mendoni edhe për mua, motrën tuaj.

Motrat e mia të dashura që keni fatin të vizitoni tokat e shenjta, Allahu jua pranoftë haxhin dhe ju bëftë të mundur që pas kësaj vizite të filloni një jetë të re! Qofshi të denja për dashurinë e Zotit dhe ndërmjetësimin e Resulullahut!

Amin!

Shefika Kaja Meriç

Si Quhesh?

Sipas një transmetimi të Ebu Derdasë, Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

"Në Ditën e Gjykimit ju do të thirreni me emrat tuaj dhe me emrat e baballarëve tuaj, prandaj vendosni emra të bukur." (Ebu Davud, Edeb, 61; Darimi, Istizan, 59.)

***

Pejgamberi ynë i nderuar na ka lajmëruar në lidhje me faktin se në Ditën e Gjykimit do të thirremi me emrat tanë, prandaj është e rëndësishme që këta emra të jenë të bukur dhe me kuptim. Emri i bukur na sjell të mira në këtë botë dhe në tjetrën. Emri ka vlerën e një stolie të çmuar. Emrat në një farë mënyre përfaqësojnë karakterin tonë.

Vënia e emrave të bukur është një nga mënyrat e mbrojtjes së brezit të ri. Sigurisht që e ardhmja e brezave mund të mbrohet vetëm nga duart e nënave dhe baballarëve. Detyra kryesore e një prindi është që ta edukojë fëmijën e vet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Le t'u vendosim fëmijëve tanë emra të cilët na përfaqësojnë, emrat që përdoren më shumë në një shoqëri flasin për moralin e asaj shoqërie. Një shoqëri që përdor emra si: Ali, Ahmet, Mustafa; flet shumë për gjendjen e vet morale.

Na kanë tërhequr vëmendjen emrat që u vendosen fëmijëve në ditët e sotme. Na shqetëson fakti se numri i prindërve që kanë turp t'i vendosin fëmijës emrin e gjyshit, gjyshes apo prindërve të vet po rritet nga dita në ditë. Atyre u duket më tërheqës emri i një aktori filmi apo i një futbollisti. Atyre u pëlqen roli që një person i njohur ka në jetën publike dhe mundohen që t'ua transmetojnë këtë gjë edhe fëmijëve të tyre. Këta prindër bëjnë sikur nuk e kanë parasysh jetën private të këtyre njerëzve të njohur të cilët i adhurojnë.

***

Nuk duhet të harrojmë se fëmija merr veçoritë e emrit që ka. Fëmija ndikohet nga emri i vet, prandaj mendoni para se të vendosni emrat; mos kërkoni emra që plotësojnë dëshirat e kësaj bote të përkohshme, por kërkoni emra që janë të favorshëm për këtë botë dhe për botën tjetër.

Rregullat e Islamit dhe ato të shoqërisë janë të qarta

për sa i përket emrave. Duhet të mendohemi mirë teksa zgjedhim një emër, sepse nuk është e pëlqyeshme që të vendosim një emër me të cilin njerëzit mund të tallen. T'i vendosësh një fëmije një emër që nuk ka kuptim do të thotë që për gjatë gjithë jetës t'i bësh keq atij fëmije.

Nuk është mirë që t'i përmendim të gjithë emrat që na shqetësojnë, por ekzistojnë shumë emra të çuditshëm në regjistrat e emrave… E kemi shumë të vështirë të kuptojmë arsyen që prindërit u vendosin këta emra fëmijëve të tyre… Le të kujtojmë faktin se kur Pejgamberi ynë nuk e ka pëlqyer emrin e një fëmije, ai emër është ndryshuar dhe fëmija është thirrur me emrin e ri. Nga kjo gjë kuptojmë se njeriu nuk është i detyruar që ta kalojë jetën duke mbajtur një emër që nuk e pëlqen, por mund ta ndryshojë atë…

Në vitet e fundit kemi vënë re modën e të vendosurit emra të huaj ose të emrave që janë të përzier me emra të huaj… Në këtë veprim duket qartë ndikimi që kanë kulturat e huaja në shoqërinë tonë… Nganjëherë fëmijëve u vendosen emra që janë të këndshëm në shqiptim, por nuk kanë asnjë kuptim. Edhe ky veprim tregon që ne mendojmë për vetveten më shumë se për fëmijën tonë.

Fëmijës sonë duhet t'i vendosim një emër i cili ka një histori, një kuptim dhe fëmija duhet që të mbushet me një energji pozitive sa herë që i përmendet emri. Për të plotësuar këto kushte nuk duhet të kërkojmë shumë. Ne kemi emrat e Pejgamberit tonë, të shokëve të tij dhe të grave të nderuara të asaj kohe. Të gjithë këta njerëz kanë qenë shembuj për njerëzimin dhe janë një thesar i çmuar i joni. Pse të kërkojmë aq shumë kur i kemi këto emra të nderuar shumë pranë nesh?!

Disa nga detyrat që prindi ka kundrejt fëmijës, sipas fesë islame janë: dhënia e një emri të bukur, dhënia e një edukimi të mirë dhe martesa.

Rëndësia që Pejgamberi ynë i ka dhënë vendosjes së emrit vjen pikërisht nga ky obligim që ka prindi.

Le ta transmetojmë bukurinë e kësaj bote edhe në emrat që përdorim… Njeriu i cili është krijesa më e lartë e natyrës sonë, a nuk meriton që të mbajë emrat më të bukur?!

Njeriu është një krijesë e cila me të gjitha të metat e veta ka aftësinë që të arrijë më lart se edhe vetë engjëjt, prandaj është detyra e nënës dhe babait që fëmijës së vet t'i vendosë një emër të denjë dhe të bukur. Allahu na bëftë mbajtës të emrave të bukur dhe njerëz që kryejnë vepra të mira! Amin!

Duaja e nënës:

"Biri im,

Kur të mora ty në krahë për herë të parë e kuptova se sa i mëshirshëm është Zoti im me mua. Kur u bëra nënë, Zoti më vendosi në zemër një pikë nga mëshira dhe dhembshuria e Tij e pakufi… Vetëm atë moment arrita ta kuptoj se sa e madhe është mëshira që një nënë ndjen për fëmijën e vet.

Kur ti u sëmure dhe kishe temperaturë unë digjesha përbrenda! Kur ti kishe ftohtë unë ngrija! Ti u rrite dhe u bërë pranverë, kurse unë mbeta vjeshtë. Rininë time e sakrifikova për ty, sepse ti ishe amaneti më i bukur i Zotit tim. Si shpërblim i këtij shërbimi unë nuk dua asgjë prej teje veçse të jesh një rob i denjë i Allahut (xh. sh.) dhe ta kalosh jetën pranë njerëzve më të dashur të Allahut.

Muhamedi, (a.s.), qoftë drejtuesi dhe shembulli më i mirë i jetës tënde! Qofsh besnik si Ebu Bekri! Qofsh i drejtë si Omeri! Qofsh i edukuar si Osmani! Qofsh i ditur si Aliu! Qofsh guximtar si Hamzai! Qofsh trim si luftëtarët e Bedrit! Duaje Pejgamberin tonë të nderuar më shumë se mua, babanë dhe veten tënde! Mos u ndaj nga rruga e drejtë edhe në qoftë se do të kushtojë shumë shtrenjtë! Ndihmo të varfrin dhe të pafuqishmin! Fjala e dëshmisë qoftë gjithmonë e pranishme në zemrën dhe në gjuhën tënde! Allahu të bëftë të lumtur në të dyja botët! Amin…

Fatma Bagan

Nga duhet t'ia fillojmë?

Allahu (xh.sh.), i ka krijuar njerëzit në raca, forma dhe natyra të ndryshme; por sigurisht që çdo njeri ka detyrimet e veta para Krijuesit të Gjithësisë. Dikush ka lindur në veri e dikush tjetër në jug. Dikush ka hedhur hapat e parë në breg të detit, dikush tjetër në shkretëtirat pa fillim e pa mbarim, dikush tjetër në majat e larta të maleve.

Allahu e ka krijuar çdo njeri sipas një zanafille, natyre. Sipas studimeve të bëra natyra dhe karakteri i njeriut formohet në bazë të vendit në të cilin hap sytë dhe në bazë të vendit ku vazhdon të jetojë.

Shikohet shumë qartë se njerëzit që jetojnë në fshat janë më të fuqishëm dhe rezistentë ndaj kushteve të vështira të jetës, kurse njerëzit që jetojnë në qytet janë të përfshirë brenda disa kufijve dhe janë të veçuar nga shumë tradita.

Njerëzit që jetojnë në zona më të vogla dhe në fshatra janë të brumosur me rregullat familjare dhe fetare. Rrjedha e tyre e jetës ndjek më shumë rregullat e krijimit. Njerëzit që jetojnë në fshat mbjellin, i bëjnë shërbim dhe korrin ushqimet që më pas do të konsumojnë. Shoqëria e këtyre njerëzve në përgjithësi përbëhet nga njerëzit e së njëjtës rrethinë.

Këtë vit patëm rastin që të vizitonim një fshat. Patëm fatin që të ishim mysafirë të një familjeje me emër të mirë në këtë fshat. Më vjen keq të pranoj se gjendja e atij fshati më shqetësoi dhe më mërziti shumë... E kuptoj shumë mirë faktin që ne jetojmë në një botë globale dhe ndryshimi është i pashmangshëm, por nuk është mirë që të largohemi nga traditat tonë shumëvjeçare.

Gjëja e parë që na bëri përshtypje ishte mënyra e sjelljes e vajzave të reja. Diçka tjetër për t'u përmendur ishte dhe fakti se në vend të vetullave të tyre natyrale tashmë qëndronte një vijë krejt e hollë... Në këtë mënyrë shprehja e tyre e fytyrës kishte ndryshuar krejtësisht. Nuk kishte asnjë shenjë nga veshja e nënave dhe gjysheve të tyre, vajzat e reja vishnin pantallona të ngushta...

Shamitë e holla të zakonshme kishin zënë vend në sënduk dhe tashmë vajzat përdornin rrobat e tyre të ngushta dhe moderne. Në fshat njerëzit visheshin me rrobat që jemi mësuar t'i shikojmë edhe në qytet. Thonjtë ishin plot shkëlqim, gjë që fliste për kohën që u jepej kujdesit për to... Shkëlqimi i thonjve na tregonte edhe se lënda që ishte përdorur për të arritur këtë gjë nuk e lejonte kalimin e ujit të abdestit... Telefonat celularë ishin gjithmonë në xhep. Butonat e telefonit ishin fshirë nga shkrimi i mesazheve. Nënat ankoheshin vazhdimisht me fjalët:

"Nuk e lëshon telefonin nga dora, deri në mbrëmje shikon televizion, mua nuk me ndihmon aspak..."

Nënat shqetësohen, sepse vajzat e tyre nuk ua dëgjojnë fjalën...

Në çdo shtëpi e cila i kishte plotësuar nevojat e veta themelore kishte ekran të gjerë plazma. Stili i vjetër i shtëpive të thjeshta e të pastra nuk dukej më askund, por ishte zëvendësuar nga divanet moderne...

Më shumë shikuam nëna se baballarë që punonin. Ne kishim shkuar për vizitë në një kohë që punët e fushës ishin shumë intensive. Gratë i gjetëm ose duke gatuar, ose duke punuar në kopsht.

"Bija ime, unë nuk mund ta dërgoj vajzën time në një shkollë për të mësuar Kuranin, sepse në qoftë se do e dërgoj nuk do të më ndihmojë më mua..."

Ndërkohë komshiu pak më larg do ta dërgojë vajzën e vet në universitet... Ai është i gatshëm që ta dërgojë vajzën e vet në një shoqëri të rrezikshme... Në të njëjtën fshat jemi përballë me dy mendime krejt të ndryshme...

I biem një dere të fshatit e cila hapet nga vajza e shtëpisë... Në sobën e ndezur ishin vendosur gështenjat... Televizioni është i ndezur tek një program i përditshëm. Vajza ka qejf të studiojë...

“Mua më pëlqen të punoj, por ju lutem mos më detyroni që të laj gjithë ditën pjata e tenxhere.”

“Sigurisht që jo! Kjo nuk do të jetë përgjegjësi e jotja... Ti do të vish atje vetëm për të mësuar...”

Disa nga nënat thonë:

“Ne nuk kishim mundësi të mësonim dhe kemi mbetur injorante; vajza jonë le të marrë mësime për fenë.”

Sigurisht që fjalën e fundit do ta thotë babai. Zakonisht baballarët nuk kanë qejf që t’i dërgojnë vajzat e tyre nëpër shkolla...

“Le të qëndrojnë këtu! Para syve tanë...”

Është njëlloj sikur të thonë: le të qëndrojnë gjithë ditën para televizionit dhe në festat me pije e kërcime të fshatit...

Dëgjojmë edhe një justifikim tjetër:

“Është shumë e zënë, është duke u përgatitur për provimet e universitetit.”

Shumë vite më përpara në çdo fshat kishte njerëz të ditur që u mësonin fshatarëve gjërat kryesore të Islamit, kurse në ditët e sotme hoxha dhe imami i fshatit janë temë humori e shakash...

Si përfundim...

Është për të ardhur keq se si zemrat e pastra të këtyre njerëzve ndoten nga televizioni dhe programet e tij të dëmshme. Njerëzit e fshatit bëjnë çdo gjë për të imituar të famshmit e televizionit.

Duhet të jemi të ndërgjegjshëm se reklamimi i gabuar i mediave nuk i bën dëm askujt më shumë se fshatarëve, këtyre njerëzve me shpirt të pastër që gjërat që shikojnë në televizion i pandehin për të vërteta dhe përpiqen t’i marrin shembull në jetën e tyre. Interneti dhe rrjetet sociale janë një tjetër faktor i rrezikshëm në jetën e këtyre njerëzve.

Telenovelat, të cilat na paraqiten si prodhime me temë familjare janë shumë të rrezikshme për shoqërinë tonë. Në pazar, në autobus, në dyqane përballemi me të rinj të pafajshëm që mundohen të imitojnë personazhet e telenovelave me anë të veshjeve të tyre. Këta të rinj ose mbyten në një jetë që nuk u pëlqen, ose mbesin në mes të dy zgjedhjeve. Në rrugë vazhdimisht shikoj të rinj me vathë të mëdhenj në vesh, me pantallona të ngushta me bel poshtë, që bëjnë përpjekje të modernizohen.

Çfarë duhet të bëjmë?

Nga duhet t’ia fillojmë? Sigurisht që nga vetja jonë... Pas kësaj duhet t’i përcjellim njohuritë tona nga njerëzit që kemi më afër deri tek ata më të largët, aq sa kemi mundësi... Mos të harrojmë se misionarët e perëndimit nuk ngurojnë të shkojnë në vende ku jetesa është shumë e vështirë për të përhapur fenë e tyre, prandaj le të luajmë rolin tonë në përhapjen e fesë së vërtetë ose do të jetë shumë vonë...

Ela Muça

Copëza lumturie

Heshtja ia mbulonte mërzinë që mbante brenda vetes. Mendonte se si do të gjente diçka që ta gëzonte, se si do të gjente një copëz lumturie…kur ndjeu një zë të ëmbël: "Mësuese, kjo është për ty!" Me sy që i qeshnin, një nxënëse mbante në dorë një trëndafil të vogël erëmirë duke ia zgjatur e duke i dhënë atë copëzën e lumturisë bashkë me mendimin e bukur...

Filluan disa pyetje të ngatërrohen në mendjen time e bardhësia e fletës të më jepte guxim: A e kërkon gjithmonë lumturinë njeriu? A e shijon apo kërkon gjithnjë e më shumë? A është i lumtur ndonjëherë apo edhe kur është ka frikë prej saj? A do ishte e natyrshme lumturia e plotë apo atëherë njeriu udhëtar do pushtonte së qeni? A është kërkimi final i njeriut?... Vërtetë, çfarë është lumturia?..

Pakëz vend, ajër, ujë, paqe, njerëz, mirësi, kaq vetëm kaq do mjaftonte për të qenë e lumtur, është e thjeshtë, lumturia është e thjeshtë dhe përbëhet nga copëza të vogla.

Por si çdo gjë tjetër nga bota e brendshme edhe lumturia është relative, gjithçka ndryshon e stuhia e pandalur e kohës mbulon copëzat e lumturisë duke e bërë njeriun herë të përqendrohet te vijat ndarëse të copëzave e si e ku t'i thellojë më shumë e herë duke e ndjellë sërish në kërkim të copëzave të tjera. Mbase është si një udhëtim i pandalur në kërkim të vetes për të njohur shpirtin, shkaqeve për t'u dhënë përgjigje pse-ve, virtytit për të qenë i fortë, natyrës për të besuar, njeriut për të jetuar, të vepruarit për të ecur, të besuarit për të qenë i drejtë... gjithmonë në kërkim, por jo larg, brenda shpirtit, aty ku lind e zhvillohet çdo ndjenjë e lartë e çdo qëllim, jo përtej brendisë së qenies e krijuar për të dalluar të mirën ndërmjet kontrastesh kur të njohë mundësitë, kufinjtë e vetes dhe kur të kuptojë se kufinjtë janë gjithkund e këtë qëllim ta gjejë ndërmjet tyre. E kur ndodh kjo, zemra qendra e të gjitha ndjenjave ndrin, mbushet me mirësi duke lumturuar çdo gjë përreth, atëherë durimi, përmbajtja, intuita, arsyetimi i qetë e logjik bëhen mjetet që i mësojnë njeriut artin, e bëjnë një artist në kërkim të lumturisë.

Nuk besoj se do ishte e natyrshme që lumturia të jetë një e tërë dhe jo në copëza dhe as e plotë, pasi jetës do i mungonte qëllimi, sprova për t'ia dale kur mbyllen të gjitha rrugët, kur çdo gjë të ngushtohet dhe dhimbja bëhet e fortë e dëshpërimi i madh atëherë është Ai që të fal copëzën tjetër e që të ndez shpresën për të të dhënë copëza pa fund që përbëjnë jetën.

Mbase edhe e frikshme do ishte një jetë e tërë e lumtur e unë as nuk e dua, por e dua në copëza të vogla që i gjej ngado: në të qeshurën e një fëmije, në vështrimin e dashur të babait, në përqafimin e nënës, në dashurinë e vëllait, në urtësinë e një miku, në sinqeritetin e një të rrituri, në ndershmërinë e njeriut, në një buzëqeshje, në një fjalë të ëmbël, në ajrin e freskët, në vështrimin e yjeve, në ngjyra, në tinguj, mes fjalësh, në fletën e bardhë…në madhështinë e Krijuesit, në lotët e adhurimit…O Zot! Sa e bukur është bota!

I gjej ngado e duke mundur realitetin shkërmues që më bën veçse të qesh e që nuk mundet të shkatërrojë copëzat e mia të lumturisë, pasi jam e do jem në kërkim të tyre gjithmonë si zogjtë në fluturim, si udhëtari në shkretëtirën e jetës në kërkim të ujit sepse e di se është Ai që dhuron pa fund copëza lumturie! E unë besoj!...

Dhe Bajrami vjen...

Dhe Bajrami vjen.

Kanë kaluar me qindra ditë, por ai nuk e ka humbur freskinë...

Janë jetuar shumë gjëra, por rregullat nuk kanë ndryshuar...

Me kalimin e viteve njerëzimi humb vlerat e veta, por Bajrami është gjëja më e bukur që është ruajtur e paprekur...

Po vjen një Bajram tjetër.

Ai vjen për të freskuar njerëzit që nuk e kanë shijuar kurrë lumturinë. Vjen për të trokitur në dyert që nuk trokitën kurrë...

Ai vjen për t'i gëzuar edhe njerëzit që janë të mbytur nga shqetësimet dhe problemet.

Bajrami vjen për t'u ofruar një kafshatë ushqim njerëzve të uritur.

Bajrami... Vjen për të përmendur të pasurin e të varfrin, fëmijën e plakun, të lumturin e të hidhëruarin. Ai vjen për të fshirë lotët... Për të lumturuar zemrat e lënduara... Ai vjen për të gjithë... Vjen për të sëmurët që e kalojnë natën duke përgjuar dritaret. Ai është shërim për të dëshpëruarit. Është bashkim për të përmalluarit...

Bajrami vjen edhe për jetimin...

Vjen Bajrami dhe mbase shëron plagët e secilit prej nesh, por sa të fshehta ruan ai.

Nganjëherë na e përplas fytyrës vetminë tonë, por gjithsesi ne e duam atë. Ai vjen edhe për njerëzit që nuk kanë më miq, sepse i kanë humbur ata. Bajrami vjen për t'i dhënë fuqi të pafuqishmit, vjen për të puthur në ballë njerëzit e nënshtruar dhe të mjerë. Bajrami vjen pas një durimi të gjatë, ai vjen si një lajmëtar i bukur i Xhenetit. Ai vjen për të zhdukur frikën; për të na dhuruar shpresë, miqësi dhe dashuri. Bajrami vjen për të qenë dashuri, sakrificë, respekt, miqësi dhe vëllazëri. Ai lumturon ata që janë mbi dhe, por edhe ata që janë nën të. Ai na kujton të shkuarën, por edhe bën një premtim për të ardhmen... Ai vjen për të na mësuar se çfarë është besnikëria.

Bajrami është një zgjim nga gjumi... Ai vjen për të bërë të vërteta ëndrrat tona.

Ai vjen për të mbledhur dhe shpërndarë të gjitha shpresat e grumbulluara gjatë natës.

Bajrami është një dritë... Sa të lumtur janë ato që mund ta shikojnë...

Kevser Atar

Jetim si Profeti

Njeriu është një krijesë e dobët. Ne jetojmë në bashkësi, sepse kemi nevojë për njëri-tjetrin. Familja është njësia më e vogël e kësaj bashkësie. Siguria dhe kujdesi për njeriun në radhë të parë sigurohet nga familja.

Si një sprovë që vjen nga Krijuesi, disa prej nesh privohen nga ky bekim që në moshë të vogël. Allahu na sprovon duke na privuar dashurinë dhe mëshirën e familjes. Disa prej nesh i humbasin prindërit pa i njohur fare, kurse disa të tjerë i humbasin pa u ngopur me erën e tyre, me këshillat e tyre. Sigurisht që është shumë e vështirë të mos kesh dikë me të cilin të bisedosh gjatë e gjatë kur vjen në shtëpi, të mos kesh dikë që në mbrëmje kur bëhet vonë të të blejë gjërat e nevojshme nga dyqani, të humbasësh një njeri tek krahët e të cilit të mbështetesh kur të jesh e sëmurë. Me ikjen e tyre dritat në shtëpitë tona shuhen. Shuhet lumturia në zemrat tona. Na duket sikur mbesim vetëm, në një shkretëtirë të pafund. Na duket sikur mbesim vetëm në mërgim pa askënd pranë...

Kjo është arsyeja që i bën jetimët të jenë me zemër të thyer e me shikim të trishtuar... Por ne që jemi ymeti i Pejgamberit (a.s.), i cili shikonte anën më të bukur të çdo gjëje, ne nuk duhet të mërzitemi nga kjo gjë. Ne duhet të gëzohemi sepse i ngjasojmë Pejgamberit tonë, i cili ka qenë jetim, duhet të jemi të lumtur sepse ndajmë të njëjtin fat, të njëjtin hidhërim me të Dërguarin.

Pejgamberi ynë i dashur ka thënë:

"Unë i jam më afër se fryma e tij çdo besimtari. Kur dikush vdes dhe lë pasuri, ajo pasuri i takon të afërmve të tij. Në qoftë se ai lë borxhe ose fëmijë jetim, ai borxh është i imi dhe të kujdesem për jetimët është detyra ime. (Muslim, Xhuma, 43.)

Njëherë tjetër Ai ka thënë:

"Shtëpia më e mirë e myslimanëve është ajo shtëpi në të cilën jetimët trajtohen mirë, kurse shtëpia më e keqe është ajo në të cilën jetimët trajtohen keq." (Ibn Maxhe, Edeb, 6.)

Duke folur për ato qe i duan dhe kujdesen për jetimët zemërthyer ka treguar gishtin tregues dhe atë të mesit dhe ka thënë:

"Unë dhe kujdestari i jetimit do të jemi si këta dy gishta në Xhenet. Sevapet e atij të cilit vetëm për hir të Allahut e përkëdhel kokën e jetimit shumohen sa numri i flokëve që prek."(Ahmed, Mysned, V, 250.)

"Atë mysliman, i cili merr një jetim në shtëpinë e tij dhe e ushqen, nëse nuk ka kryer ndonjë gabim të pafalshëm, Allahu e vendos në Xhenet." (Tirmidhiu, Birr, 14/1917.)

Dashuria është thelbësore për njeriun aq sa janë ushqimi dhe uji, ajo është faktor i rëndësishëm për një rritje të shëndetshme dhe të sigurt. Dashuria që fitohet në moshën e fëmijërisë është kapitali më i madh i së ardhmes së një fëmije. Jetimët ose fëmijët familja e të cilëve është ndarë janë ata që nuk e zotërojnë këtë dashuri.

Në këtë temë duhet marrë si shembull Ai që është shembulli unik në çdo çështje: Pejgamberi ynë (a.s.). Ai ka përkëdhelur kokën e çdo jetimi, të njohur e të panjohur. I ka marrë ata në shtëpi, i ka ushqyer.

Një ditë kur kishte dalë nga xhamia pas namazit të Bajramit kishte shikuar që të gjithë fëmijët po luanin të lumtur, përveç njërit që po qante i mbështetur në një mur. Menjëherë i ishte afruar dhe e kishte pyetur:

"Çfarë ke biri im, pse je i mërzitur? Pse nuk luan me shokët e tu?"

Fëmija i tregoi se babai i tij kishte rënë dëshmor në luftën e Uhudit, nëna e tij ishte martuar me një njeri tjetër kështu që ai kishte mbetur i vetëm. Sulltani i zemrave, Pejgamberi ynë ia merr dorën dhe i thotë:

"-Pse qan? A nuk do ti që unë të jem babai yt, Aishja nëna jote dhe Fatma motra jote?"

Fëmija e shikon plot lumturi Pejgamberin dhe i thotë:

"Si të mos dua, o i Dërguar i Allahut?"

Pejgamberi ynë e merr në shtëpi fëmijën, i jep për të ngrënë dhe e vesh atë.

Pas këtij trajtimi fëmija del në rrugë e fillon të luajë me fëmijët e tjerë. Shokët e Beshirit çuditen kur shikojnë këtë ndryshim tek ai dhe e pyesin:

"Ti pak më përpara po qaje, ç'të ndodhi që u bëre kaq i lumtur?"

Beshiri u përgjigjet:

"Isha i uritur, tani jam i ngopur; isha pa rroba, tani jam i mbathur më së miri; isha jetim, tani kam baba Pejgamberin e nënë Aishen."

Fëmijët e tjerë të cilët e lakmuan gjendjen e tij, iu përgjigjen:

"Ah sikur dhe baballarët tanë të kishin rënë dëshmorë në luftën e Uhudit, që edhe ne të ishim bërë me një baba kaq të nderuar!.."

Beshiri qëndroi pranë Pejgamberit (a.s.), deri në vdekjen e Tij. Kur dëgjoi për largimin e Pejgamberit nga kjo botë Beshiri filloi të qante dhe tha:

"Tani mbeta jetim, tani jam i gjorë."

Mëshira dhe kujdesi për fëmijët jetimë ashtu siç na kanë këshilluar Allahu dhe Pejgamberi ndikon shumë në gjendjen shpirtërore të njeriut. Kujdesi për fëmijët jetimë zbukuron karakterin dhe moralin e njeriut, e bën më të ndjeshëm atë. Ebu Derda (r.a.), ka thënë:

"Erdhi një njeri pranë Pejgamberit të nderuar dhe u ankua për ngurtësinë e zemrës tij. I Dërguari e këshilloi të merrej me njerëzit që janë të brengosur duke i thënë: *'Tregohu i mëshirshëm me jetimin, përkëdhelja kokën, ushqeje atë me ushqimin tënd.'"* (Ahmed bin Hanbel, Mysned, II, 263, 387)

Të gjithë ata njerëz që kanë hyrë në bashkësinë islame, që janë ymet i Pejgamberit(a.s.), janë bërë njerëz të mëshirshëm, të ndjeshëm.

Në këtë bashkësi nuk ka njerëz jetimë apo të vetmuar. Vetmia e vetme është privimi nga dashuria dhe pëlqimi i Allahut dhe të Dërguarit.

Shule Sever

HAXHERI

Simboli i mbështetjes ndaj Allahut, e kredhur në oqeanin e dashurisë ndaj Tij

Migrimi e ka fillimin te dashuria.

Ata që patën pikë referimi tokën tënde, ata që gjithmonë ishin në pritje të pranverave të reja; dëgjuan tregimin tënd përgjatë shekujve...

Emri yt freskonte karvanët që derdheshin mbi shkretëtirat e nxehta dhe ishte si një fllad për shpirtrat që vraponin në kërkim të guximit dhe këmbënguljes...

Netët e shkretëtirës, dëshmitare të shpirtit tënd të pastër u hakërroheshin zemrave tona të ashpra, u tregonin atë që përfaqëson emri yt: mesazhin e hixhretit (emigrimit)... Çdo grimcë rëre na mësonte duatë e tua...

Kur burri yt i bekuar Ibrahimi (a.s.), të la në mes të erërave të shkretëtirës zemra jote e ndjeu atë që kishte vendosur Zoti, zemra jote ishte e bindur për të mirat që do të vinin... Ti që ishe paraardhëse e Njeriut te Ndriçuar, emri yt u bë personifikim i durimit.

Ti ishe nënë... Duart e tua para se të vendosnin themelet e Qabes, vendosën themele të forta e të pastra në shpirtin tënd. Ti ishe nëna e Ismailit (a.s)... Ti ishe ajo që nuk ngurove asnjë çast për të flijuar trupin tënd për hir të Krijuesit të gjithësisë...

Ne të kujtojmë ty si robëresha që iku nga sarajet e Egjiptit për të shtegtuar drejt rrugëve të vështira të Mekës... Përpjekja jote që filloi me kodrat e Safas dhe Merves është si jehona e dashurisë dhe e luftës në rrugën e drejtë... Duaja jote bëri të lulëzonte begatia në vendin e shkretë... Udhëtarët që freskohen me ujin e zemzemit, atë ujë që buron nga toka e shpresës, përmendin emrin tënd...

Ti... Simboli më i mirë i mbështetjes te Allahu, e kredhur në oqeanin e dashurisë ndaj Tij...

***

Haxher... Në Kuran emri i saj nuk përmendet qartë por kjo grua e bekuar është nderuar duke qenë gruaja e një Pejgamberi dhe nëna e një Pejgamberi tjetër. Ne kemi të dhëna për jetën e saj vetëm pas martesës me Ibrahimin (a.s)... përpara kësaj martese nuk ka njohuri në lidhje me jetën e saj, dihet vetëm që ka qenë skllave e faraonit.

Por Haxheri asnjëherë nuk kishte reshtur së shpresuari tek ndihma e Zotit, dhe gjithmonë kishte besuar ne Allahun (xh.sh.), duke dalë kundër urdhrave të faraonit... Edhe kur biri i saj po dërgohej për t'u bërë kurban, ajo u tregua e durueshme dhe e nënshtruar... dhe në fund të fundit ajo që në fillim u duk si diçka e keqe qëlloi të ishte diçka e mirë... Të gjitha këto cilësi të mira të saj e shumë të tjera që nuk i kemi përmendur bëjnë që emri i saj të mbetet i pavdekshëm...

Minutat janë shumë të rëndësishme, apo jo? Koha është shumë e vyer... Nganjëherë një jetë e gjatë varroset në faqet e historisë për t'u harruar, por nganjëherë një pjesë e vogël e jetës së një njeriu bëhet aq e rëndësishme, saqë u jep mesazhe edhe brezave që e pasojnë. Një veprim i vogël i bërë me dashuri, një hedhje guri drejt veseve të këqija mund të bëhet një shembull i fuqishëm për anëtarët e një feje. Kjo është ajo që duhet menduar duke lexuar historinë e saj... Pjesët që formojnë jetën tonë çfarë janë? A jemi krenar për të shkuarën apo në jetën tonë ka pjesë të cilat do të donim t'i fshijmë nga e kaluara..? Kujt i japim shembull, kujt i japim drejtim me veprimet tona? A kemi në jetën tonë gjëra të cilat mund t'ia bëjmë dhuratë njerëzimit, veprime me të cilat Allahu është i kënaqur..? A jemi njerëz për t'u marrë shembull?

Haxher është bashkëshortja e atij që merret si një nga baballarët e njerëzimit, është bashkëshortja e Ibrahimit (a.s.)... Ajo është nëna jonë... A mundemi ne të jemi një shembull për fëmijët tanë ashtu siç ishte ajo për fëmijët e saj, një shembull i moralit të lartë? Apo e gjithë jeta jonë do të kalojë si një nënë

që merret vetëm me problemet e kësaj bote? A do të jemi vetëm kaq?

Le të jetë kjo histori si një shkak i fillimit të një faqeje të re në jetët tona... Le të jetë nëna jonë Haxher një shembull i paharrueshëm për të gjithë brezat...

***

Shenjat e këmbëve të tua kanë mbetur mbi trupin e zemëruar të shkretëtirës... Për ku zvarritesh kështu e humbur, e larguar nga egoja... Në disa vende shikohen disa shenja në formë grope, janë shenjat e gjunjëve të tu.. kur ti e lodhur nga ecja pas bashkëshortit je rrëzuar mbi gjunjë në tokën e shkretëtirës... Në krahë mban djalin që me pamjen e tij plot dritë ndriçon çdo gjë... Babai që ecën në krye ndalet herë pas here për t'ju ndihmuar... Rruga është e vështirë... Ky është një rrugëtim drejt së panjohurës... Të shikosh arsyen që fshihet pas gjërave që njerëzve u duken të paarsyeshme është edhe më e vështirë... Por drita që ndriçon fytyrën e fëmijës të jep forcë, është si një burim që freskon zemrën tënde... Kur për një çast një hije dyshimi lind në sytë e tu, burri yt, Miku i Allahut flet me fjalë që të prekin zemrën dhe shpresa jote ringjallet ...

Sa e bekuar je... Je gruaja e Ibrahimit dhe nëna e një prej njerëzve të ndriçuar, e Ismailit... Ishe vetëm një robëreshë në oborret mbretërore të Egjiptit... Në atë kohë kur një grua e bukur hynte në Egjipt, Faraoni e merrte pranë vetes dhe i vriste bashkëshortin. Kur dëgjoi se në Egjipt erdhi Sara, që ishte një grua shumë e bukur, me bashkëshortin e saj Ibrahimin (a.s.), Faraoni menjëherë dëshiroi të vepronte në të njëjtën mënyrë. Por Sara ishte e ruajtur nga Allahu (xh.sh.), dhe Faraoni nuk mund t'i afrohej asaj.

Faraoni kur i kuptoi cilësitë e saj, i frikësuar e kishte lënë të lirë Sarën dhe për të shpëtuar nga të këqijat që mund t'i vinin i kishte dhënë dhe shumë dhurata... Haxher ishte një prej këtyre dhuratave.

Haxheri kishte qëndruar në Sham pranë Sarës. Sara e kishte të pamundur të lindte fëmijë, për këtë arsye kishte kërkuar martesën e Ibrahimit (a.s.), me robëreshën e saj. Ajo shpresonte që nga kjo martesë Ibrahimi (a.s.), të bëhej me një fëmijë dhe ashtu ndodhi, nga kjo martesë lindi drita e syve të tij, Ismaili...

Kishin hyrë në një vend të shkretë. Rreth e rrotull nuk kishte njerëz. Haxheri u ul në hijen e një hurme... Nuk arrinte të kuptonte arsyen që i kishte shtyrë të vinin në këtë vend. Sytë e Ibrahimit (a.s.), ishin të heshtur... Ai po u kthente shpinën për t'u larguar... Dëgjohet një zë i lehtë gruaje... Deti brenda syve të Ibrahimit (a.s.), fillon t'i rrjedhë atij nëpër faqe...

"Si po ikën dhe po na lë vetëm?!"

Sytë e Mikut të Zotit janë të mbushur me lot... Zemra e tij e mëshirshme papritur kujtohet për urdhrin hyjnor... Ngre kokën dhe mendon për atë që i ka pëshpëritur më përpara Xhebraili...

"O Ibrahim!... Strehoje këtu familjen tënde!"

"Po ky nuk është një vend i përshtatshëm për jetesë..."

Xhebraili i thotë:

"Po, ashtu është, por këtu nga brezi i djalit tënd do të dalë Pejgamberi i të gjithë pejgambereve dhe Fjala më e Lartë: Fjala e Dëshmisë do të plotësohet me Të."

Sytë e mbyllur hapen dhe njëherë dhe pyetja përsëritet:

"Si po ikën dhe po na lë vetëm?!"

Deti në sytë e tij trazohet dhe njëherë... Zemra e Haxherit është e frikësuar dhe ajo përsërit pyetjen... Ndërkohë zemra e Mikut të Allahut është në një luftë të brendshme.

"A të urdhëroi Allahu të na lije këtu?"

Më në fund erdhi pyetja që po priste..

"Po."- përgjigjet, "Allahu më urdhëroi."

Pas kësaj Haxheri nuk pyet për frikën që kishte më përpara... Me guxim thotë:

"Atëherë ti ik, Zoti ynë do të na ruajë, nuk na lë në humbje."

Në këtë mënyrë Ibrahimi (a.s.), niset për rrugë... Zemra e tij e mëshirshme dridhet nga lumturia... Pas ka lënë një grua me bindje e qëndresë të lartë e bashkë me të është dhe fëmija i tij, ai fëmijë që do të bëhet babai i njerëzimit.

"O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi, në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë." (Ibrahim, 37)

***

Ibrahimi (a.s.), ishte zhdukur nga horizonti... Silueta e tij ishte shuar si një flakë qiriu. Ajo kishte mbetur e vetme me djalin e saj... I kishte mbetur shumë pak ujë.

Koha kalonte... Ishte shumë nxehtë... Nuk frynte aspak erë.. Ismaili filloi të përpëlitej... Nëna i jep atij pikat e fundit të ujit... Por nuk ka më... Uji mbaroi...

Çfarë do të ndodhë tani? Ismaili ka filluar të qajë... Nëna dëshpërohet, por pa gjetur rrugëdalje... Ka harruar edhe etjen e vet... Ismaili përpëlitet si një zog i vogël...

E ndërsa foshnja përpëlitet shqetësimi i nënës bëhet më i madh... Ujë, ujë... Vetëm një gllënjkë... Zoti nuk do të na braktisë, jam e sigurt...por duhet bërë diçka... Nuk mund të qëndrojë ulur pa bërë asnjë gjë... duhet bërë një përpjekje... Duhet derdhur djersë për të fituar diçka...

Me këtë gjendje shpirtërore, e mbushur me shpresë vrapon Haxheri... Me atë zjarr në zemër vrapon shtatë herë mes Safas dhe Merves... Në veshë i gjëmon zëri i Ismailit... Shtegtimi drejt Zotit kurorëzon qiejt... Në këtë tokë do të ndodhë një ndryshim i madh... Ky vend do të jetojë një pranverë të begatë.

“Bekuar të qoftë hixhreti o Haxher!”- do të thonë qiejt...

Dhe do të vazhdojnë ta përgëzojnë duke thënë:

“Bekuar të qoftë hixhreti ty që ndryshove tokën ku këmba jote shkeli. Ajo tokë fitoi një kuptim të ri prej teje. Ti që je personifikimi i mbështetjes ndaj Allahut i dhe lumturi tokës ku shkele... Qofsh gjithmonë në paqe... Le të mos shuhet kurrë zjarri që ndez zemrën tënde...”

Kur po qëndronte mbi kodrën Merve dëgjoi një zë... Ishte zëri i Xhebrailit...

“Hesht dhe dëgjo me kujdes!..”

Haxher e shqetësuar dhe kureshtare ktheu kokën nga vinte zëri:

“Ju jeni nën mbrojtjen e Allahut!... Nuk duhet të frikësoheni! Ky është vendi i shtëpisë së Zotit. Atë Shtëpi do e ndërtojnë ky fëmijë me babanë e tij. Allahu nuk e lë në humbje ndërtuesin e kësaj Shtëpie.”

Haxherit po i merrej fryma...

Zot! Në vendin ku Ismaili kishte përplasur këmbët filloi të dilte ujë me një furi që sinkronizohej me emocionin e Haxherit. Haxheri ishte e hutuar nga emocioni... Duke u frikësuar nga mbarimi i ujit krijon një prag dheu rreth tij dhe e kthen në një pishinë të vogël... Nga frika i thërret ujit: “zem zem” (ndalo, ndalo!).

Pi ujë plot mirënjohje ndaj Allahut dhe në çdo gllënjkë e falënderon Atë... Ismaili ushqehet me qumësht...

Tashmë u bëhet i qartë sekreti i vendit ku Ibrahimi është urdhëruar të linte familjen e vet. Pas një kohe të shkurtër një fis me emrin Xhyrhymiler vjen në këtë vend dhe kërkon të banojë këtu. Kjo toke e shkretë është begatur nga duaja e Ibrahimit (a.s.) dhe morali i lartë i Haxherit...

***

Tani le të flasim për ty, o udhëtar i kësaj bote...

Lëviz dhe ringjallu...

Jeta është e mbushur me vajtje-ardhje me zbritje e ngritje... A është zemra jonë si një vrapim i Haxherit? Dashuria jonë për Zotin a shpërthen si një burim Zemzemi prej kraharorëve tanë... Drejt kujt vrapojmë ne, drejt kujt migrojmë? Apo mos ndoshta jeta jonë e mbushur me telashet e kësaj bote kalon vetëm duke u shqetësuar për gjëra materiale?

A mendoni se në këtë kohë ku çdo gjë vendoset e gatshme para nesh edhe ato gjëra që shpirti ynë i dëshiron por për të cilat nuk bën shumë përpjekje, do të na vijnë si me magji në duart tona?! E dimë që çdo gjë e bukur të shton dëshirën për ta kërkuar, prandaj, nëse një njeri ka dashuri në zemër atëherë atij do t’i hapen perdet e fshehtësisë...

Dashuria është e domosdoshme për një jetë të mbushur me besim... Ajo është rruga drejt shpresës... Dashuria është dora që na ndihmon të futemi në derën e moralit të lartë.

Dorëzimi në duart e Allahut do të thotë lehtësim nga telashet e kësaj bote... A ka ndonjë fuqi më të madhe se sa të pranojmë me shpirt lartësinë e Tij?

Duhet bërë përpjekje pa u dorëzuar... Duhet bërë përpjekje me dashuri, shpresë dhe mbështetje tek Allahu... Qëllimi ynë më i madh në jetë duhet të jetë lënia si kujtim brezave pasardhës një jetë të mbushur me vepra të mira...

Rukije Gënyly

Mos i bëj padrejtësi Jetimit!..

Allahu (xh.sh.), në Kuran thotë:

"***Prandaj, mos e shtyp jetimin!***" (Duha, 9)

I zoti i jetimit është Allahu (xh.sh.). Ai i cili e sulmon atë dhe që i bën keq atij do të përballet me hidhërimin e Krijuesit të gjithësisë.

Nga ana tjetër, njeriu që e merr në mbrojtje jetimin do të jetë i mbrojtur nga Allahu (xh.sh.). Allahu e shton begatinë e tij, ia lartëson zemrën dhe e mbush shpirtin e tij me mëshirë e dhembshuri.

Pejgamberi ynë i dashur ka qenë jetim. Ai e ka humbur babanë që para se të vinte në këtë botë, për këtë arsye ai kurrë nuk e harroi gjyshin Abdulmutalib dhe xhaxhain e tij Ebu Talib të cilët e rritën. Kur vdiq gruaja e Ebu Talibit ai u mërzit sikur të kishte humbur nënën e vet të vërtetë, sepse ajo grua e bekuar ishte sjellë me atë jetim më mirë se sa sillej me fëmijët e vet, ishte munduar të mos bënte asnjë veprim që mund ta hidhëronte Atë.

Fëmijët jetimë janë si zogj me krahë të thyer. Të arrish në zemrat e tyre është sa e lehtë aq dhe e vështirë. Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"*Me jetimin sillu si një baba i dhembshur.*" Me këtë hadith ai na këshillon të jemi të dashur me të gjithë fëmijët jetimë që ndodhen në rrethin tonë, në qytetin tonë.

Në të vërtetë, ne jemi ata që përfitojmë kur kujdesemi për jetimin, sepse në një hadith tjetër Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Nëse dëshiron që zemra jote të zbutet, ushqe një të uritur, përkëdhel kokën e një jetimi!.."

Vendet të cilat strehojnë një jetim mbushen; janë të begata. Në lidhje me këtë çështje, Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Shtëpia më e mirë është ajo shtëpi që sillet mirë me fëmijët jetimë. Sevapet e atij që vetëm për hir të Allahut e përkëdhel kokën e jetimit shumohen sa numri i flokëve që prek."

Nga kjo kuptojmë që fëmijët jetimë nuk duhen lënë në rrugë; ne e kemi për detyrë të kujdesemi për ta, duhet t'i plotësojmë nevojat e tyre. Nuk duhet harruar që ata kanë shumë nevojë për fjalë të bukura, mëshirë, dashuri dhe moral të pastër. Sigurisht që edhe nëse stomaku i tyre ngopet në këtë mënyrë, ata përsëri kanë nevojë për dashurinë e prindërve të vërtetë.

Në Kuranin e Lartë çështja e jetimëve përmendet në këtë mënyrë:

Ata kërkojnë prej teje** (o Muhamed) **që t'i sqarosh lidhur me çështjet e grave. Thuaju: "Për çështjet e tyre ju sqarojnë Allahu dhe Libri që ju lexohet, si për femrat jetime, të cilave nuk u jepni dhuratën e caktuar për ato edhe pse dëshironi të martoheni me to, ashtu edhe për fëmijët e mitur. Allahu ju udhëzon që të silleni drejt me jetimët. Allahu është në dijeni të çdo të mire që bëni." (Nisa, 127)

Nga ky ajet kuptojmë se duhet të kemi kujdes për mallrat e jetimit, nuk duhet që ato mallra t'i ngatërrojmë me mallin tonë; por ky paralajmërim nuk duhet të na bëjë ne që të tërhiqemi nga përdorimi me qëllim të mirë i mallrave të një jetimi. Ne duhet t'i ndihmojmë dhe t'i mbrojmë deri kur të arrijnë moshën e pjekurisë, pra kur të jenë në gjendje të kujdesen vetë për mallrat e tyre. Gjithmonë duhet të kemi parasysh që Allahu i di më së miri zemrat e çdonjërit prej nesh. Ai e di se me çfarë qëllimi kujdesemi ne për mallin e jetimit, dhe se si e përdorim atë; e kush mund ta dijë më mirë këtë se Krijuesi i gjithësisë?!

O Zot, na bëj prej atyre që i ndihmojnë dhe i përkrahin jetimët!... Bëj që kurrë të mos hamë nga kafshata haram ose të dyshimta; na ndihmo që të mos marrim me të padrejtë mallin e jetimit!.. Na bëj ne komshi të të Dashurit Tënd në Xhenet!... Amin!

Adem Gynesh

Kur i thuhet “JO” fëmija inatoset

Të mundohesh ta edukoshë fëmijën me “ndalesa” dhe me “jo” është një nga sëmundjet e ditëve të sotme... Për fat të keq në shumë libra për edukimin e fëmijëve u jepen këshilla prindërve se si t’u thonë jo fëmijëve gjatë edukimit të tyre dhe si të mos kthejnë nga vendimi i tyre pas momentit që u kanë thënë “jo” për një çështje.

Përkundrazi fëmija, sa më shumë të dëgjojë fjalën “Jo! Mos! Është e ndaluar!”, aq më shumë inatoset. Fëmija, gjatë kohës që rritet, mundohet të njohë sendet dhe të kuptojë lidhjen që kanë sendet me ngjarjet. Fëmija duhet patjetër ta njohë dhe ta mësojë me detaje çdo send që prek me dorë dhe çdo objekt me të cilin interesohet. Fëmija është i detyruar ta njohë sendin. Kjo është një nxitje e vendosur në krijimin e tij dhe që nuk mund të ndalohet (frenohet).

Përveç njeriut asnjë gjallesë tjetër nuk ndjen nevojë për të njohur sendet përreth dhe nuk mundohet të bëjë lidhjen mes sendit dhe ngjarjeve. Nëse sillni një magjistar, nëse iluzionistët më të famshëm japin shfaqje në një sallë përpara maceve, asnjë mace nuk ndan pesë minuta kohë dhe nuk shpreh interes ndaj atyre iluzionistëve që të shastisin...

Nëse i njëjti magjistar do të jepte të njëjtën shfaqje përpara njerëzve, ata do ta ndiqnin pa u mërzitur e me admirim për orë të tëra. Ata bëhen kureshtarë për të mësuar se si ndodh, për të kuptuar dhe përkufizuar lojërat që ekspozon magjistari. Edhe pasi mbaron shfaqja, ata e komentojnë me njerëzit që takojnë. Bisedojnë me njëri-tjetrin si mund të ishtë bërë njëra nga hiletë.

Ne, emocionit që ndjen njeriu për të “kuptuar” një send apo një ngjarje, i themi “merak” (kureshtje).

Njeriu pa kureshtje është njeri me probleme!

Allahu, kur e krijoi njeriun, i vuri një ndjenjë kureshtjeje në mënyrë që njeriu me këtë ndjenjë të mund të njohë jetën, që të mund të perceptojë ambjentin ku jeton dhe për të vazhduar jetën në këtë ambjent.

Kureshtja është gëzimi i njeriut për të jetuar dhe energjia e një lëvizjeje të çuditshme që e bën njeriun të gjallë.

Njeriu pa kureshtje është njeri që mban përbrenda ndjenja të rezikshme.

Mendoni; a shqetësohet një vrasës për fëmijët e një personi të cilin do ta vrasë? Nuk shqetësohet...Nëse shqetësohet, nëse mendon se çfarë do të përjetojnë fëmijët kur të mbesin pa baba, nëse afrohet dhe hyn në botën e atyre fëmijëve, vrasësi nuk e kryen vrasjen...

Një hajdut nuk mendon për humbjen materiale që do të pësojë personi në shtëpinë e të cilit do të bëjë vjedhjen... Madje as që i intereson... Sikur të shqetësohet pak e të mendojë: “Për të marrë këto

sende, këta persona kanë harxhuar një jetë të tërë... Kushedi si janë integruar këta njerëz me këto sende.", nuk mund ta kryejë vjedhjen.

Ndjenja e kureshtjes është si uji që rrjedh. E mban zemrën e njeriut të qartë dhe e pastron atë. Njeriu pa kureshtje është si uji që ka filluar të marrë erë në buzë të përroit.

Mban brenda vetes lloj-lloj gjërash të pista dhe pas një kohe kthehet në kënetë. Ashtu siç shkatërron veten, shkatërron edhe atë që merr me vete...

Kureshtja, ashtu siç mundëson thellimin e ndërgjegjes, **"është edhe dinamika themelore e edukimit."**

Po nuk pat kureshtje, nuk mund të ketë sukses në edukim

Po nuk pat kureshtje, nuk mund të mendohet të ketë sukses një fëmijë në edukim. Një fëmijë pa kureshtje, edhe sikur të kalojë 4-5 vjetë duke u munduar në shkollë, nuk mund ta vazhdojë edukimin.

Përsëri është ndjenja e kureshtjes ajo që e paraprin njeriun drejt dijes... Ajo që nxjerr në pah zbulime të reja...

Dhe është gjithmonë ndjenja e kureshtjes që e bën njeriun t'i referohet shpirtërores... Kureshtja është dinamika themelore që mundëson besimin te njeriu...Është ndjenja e kureshtjes ajo që na bën të mendojmë "Çfarë dhe e kujt është kjo bote me gjithë çka brenda?"... Është ndjenja që zgjon bërthama e kureshtjes te njeriu, forca që për orë të tëra komenton botën në pozicionin e çudisë "Kush jam? Çfarë jam? Nga kam ardhur? Ku po shkoj?"

Ta pengosh fëmijën duke i thënë "Jo", do të thotë t'i hedhësh helm ndjenjës së tij të kureshtjes

Helmi i një ndjenje të tillë që e bën njeriun njeri, i hidhet shpirtit të fëmijës në vitet e fëmijërisë nga vetë prindërit. Prindërit "për t'ia dalë mbanë" ose "që fëmijët të mos prishin rregullin e shtëpisë", ose ngaqë "nuk janë në dijeni se çfarë përjeton fëmija gjatë kohës së zhvillimit mendor dhe shpirtëror", kur fëmija prek sendet me dëshirën për t'i njohur, e pengojnë duke i thënë "Jo!.. Mos!.. Mos e prek!.. Hiqe dorën!.."

Fëmija, kur i zgjat dorën një sendi për ta prekur, me ndjenjën e brendshme të kureshtjes kërkon të mësojë: "Po ta prek, çfarë i ndodh?" Sepse ai është një njeri dhe Allahu i ka vënë brenda edhe atij ndjenjën e kureshtjes.

Një fëmijë, ndërkohë që luan me një letër në dorë, tingulli "shër, shër" që nxjerr letra, e bën kureshtar atë dhe i emocionuar e rrudhos letrën. Nëse fëmijës papritur i vjen një shuplakë në kokë dhe i thuhet:

"Lëre atë, do ta grisësh gazetën!..", emocioni i fëmijës për të mësuar shuhet...Ose ndërkohë që një fëmijë 4-5 vjeç i cili ka zgjatur dorën te çezma dhe nxjerr klithma lumturie nga uji që i prek lëkurën e që i ngjall ndjenjën e gudulisjes, tërhiqet për krahu dhe shtyhet duke iu thënë:

"Sa herë të kam thënë të mos luash me çezmën!..Ik prej aty!..." Prindërit që ia bëjnë këtë fëmijës, duhet të frikësohen për të ardhmen.

T'u thuash "jo", "mos e bëj" fëmijëve dhe t'u vendosësh "pengesa" përpara proçesit të mësimit në periudhën e zhvillimit të tyre, do të thotë që t'u godasësh ndjenjën e kureshtjes. Këto goditje e ndalojnë edhe zhvillimin e ndjenjës së ndërgjegjes në shpirtin e fëmijës.

Pejgamberit (a.s.) nuk i pëlqente fjala "Jo"

Një nga sahabët e famshëm nipi i Sa'sa en-Naxhijes (r.a.), Shair Ferazdak, ndërsa po përshkruante Pejgamberin, (a.s.), tha:

"Sikur të mos ishte "La" në fjalën "La ilahe illallah", nga gjuha e tij nuk do të ishte dëgjuar kurrë fjala "La" (Në arabisht fjala "La" ka kuptimin "Jo, nuk ka")

Nëse Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, i cili i bëri njerëzit, që varrosnin të gjalla vajzat e tyre, aq të ndjeshëm ndërgjegjshmërisht sa të mos shtypnin edhe një milingonë, nuk e do fjalën "Jo", si mundet që prindërit e sotëm ta përdorin këtë shprehje në edukimin e fëmijëve?

Nuk rritet dhe nuk zhvillohet fëmija duke i thënë "Jo".

Të zbulosh forcën e "Po"-së në edukimin e fëmijëve

Edukimi i fëmijëve me "Jo", "Ndalesa" dhe "Pengesa" është një sëmundje që është futur vonë në familjet e Anadollit. Për të rritur një njeri të formuar, të sinqertë, me dinamika të forta shpirtërore dhe me ndjenja të zhvilluara ndërgjegjeje, duhet t'i hapet rruga që në vitet e fëmijërisë dhe duhet të mbështetet kundrejt gjërave për të cilat ai është kurioz; Në vend që të përdorim shprehje si "Jo! Mos e prek! Ndal, mos e bëj!", është më e rëndësishme t'i themi: "Eja, merre...Preke...Ndjeje..." Për këtë arsye dinamikat e brendshme të atij fëmije zënë vend.

Një fëmijë, nëse nuk pengohet gjatë kohës së zhvillimit, nëse nuk ndryshohen "tiparet e tij të krijimit", nëse i hapet rruga dhe familja e pranon atë në shoqëri me gjendjen e tij të natyrshme, ai bëhet "njeri dhe i zhvillohen tiparet njerëzore".

Dr. Betyl Inall

Si të ushqejmë foshnjat 9-12 muajshe

Cila është arsyeja që foshnjat nën moshën 6 muajshe nuk duhet të ushqehen me produkte të tjera përveç qumështit të nënës?

- Ushqimi me produkte të tjera përveç qumështit të nënës nuk e ndihmon fëmijën që të rritet më mirë.

- 4 muajt e parë janë periudhat kur foshnja duhet të ushqehet me qumësht. Në këtë periudhë ushqimet që i jepen me lugë ai i shtyn me gjuhë, pasi nuk është mësuar akoma me to.

- Foshnja që nuk ka mbushur katër muaj nuk e ka të zhvilluar refleksin e përtypjes.

- Kontrollimi i kokës dhe lëvizjeve të fëmijës është i vështirë në këtë moshë, prandaj nuk është mirë që të ushqehet me ushqime shtesë.

- Ushqimet e dhëna mund të rrezikojnë mbytjen e foshnjës.

- Foshnjat në këtë moshë nuk e pëlqejnë ushqimin.

- Produktet që u jepen për ushqim bëjnë që fëmija të kërkojë më pak qumësht.

- Nga nëna tek fëmija nuk kanë kaluar të gjithë faktorët mbrojtës për të cilët ai ka nevojë prandaj fëmija rrezikohet nga infeksionet. Nga ana tjetër, këto sëmundje e dëmtojnë oreksin e fëmijës dhe bëhen shkak për rënien e tij në peshë.

- Produktet shtesë me të cilat ushqehet fëmija bëjnë që sasia e mineraleve dhe natriumit tek fëmija të rritet shumë.

- Produktet që jepen shumë herët i hapin rrugë lindjes së alergjive ushqimore.

- Ushqimet e dhëna më herët se koha e duhur i hapin rrugë rrezikut të obezitetit.

- Në dy muajt e parë nuk është i këshillueshëm ushqimi i fëmijës me produkte të tjera përveç qumështit të nënës, pasi organizmi i fëmijës nuk është i përgatitur për këtë gjë.

Kur foshnja bëhet gjashtë muajsh

Kur fëmija bëhet gjashtë muajsh të gjitha këto pengesa që përmendëm më sipër zhduken dhe fëmija është gati për t'u ushqyer me produkte të tjera përveç qumështit të nënës. Për më tepër që në këtë moshë foshnja ka nevojë për vitamina të tjera që qumështi i nënës nuk i siguron dot. Fëmija fillon të jetë i pavarur nga nëna. Foshnja në këtë moshë mund të sillet vetë, kur e ndihmojnë mund të ulet vetë, mund të ketë dëshirë të fusë në gojë diçka që i jepet, mund të mbajë një gotë me të dyja duart. Në këtë moshë fëmija arrin të kuptojë shijen e ushqimit dhe ka dëshirë që ta marrë ushqimin në duart e veta.

Foshnja në këtë moshë duhet të jetë e lirë që të ushqehet ashtu siç ka dëshirë, por edhe të ruhet në mënyrë që të mos ndodhë ndonjë aksident. Duhet të kemi kujdes që fëmija mos të gëlltisë lojëra të vogla, rruaza, ilaçe, produkte që përdoren për pastrim, detergjente apo gjëra të tilla të ngjashme. Këto rreziqe mund të ndalohen duke e ulur fëmijën në një karrige të vogël.

Ditët kur foshnja fillon të mësohet me ushqime të reja janë ditët kur dalin edhe dhëmbët e parë. Në fillim dalin dhëmbët prerës të poshtëm pastaj dhëmbët lart.

Fëmija mund të jetë i irrituar për shkak të dhimbjes që i jep dalja e dhëmbëve. Ai mund të ketë vështirësi që të flejë, mund të zgjohet duke qarë. Mund ta fusë dorën në gojë dhe të ketë dëshirë të përtypë diçka gjatë gjithë kohës. Mishi i dhëmbëve mund të duket i skuqur dhe i ënjtur. Fëmija mund të ketë një temperaturë të lehtë. Fëmija mund të kërkojë vetëm qumështin e nënës dhe të refuzojë çdo gjë tjetër.

Prindërit nuk duhet të shqetësohen nga këto gjëra që janë më se të zakonshme, por me durim duhet ta mësojnë foshnjën që të përshtatet me ushqimet e tjera. Mësimi i fëmijës që në këtë moshë të hershme me ushqime të ndryshme do të ndihmojë fëmijën që të mos ketë probleme me ushqimet në vitet në vazhdim. Periudha e daljes së dhëmbëve do të jetë pak e vështirë për ju edhe për fëmijën tuaj. Dhënia në dorë e gjërave të forta dhe të ftohta mund ta ndihmojë fëmijën për të ulur dhimbjen. Në rastet kur fëmija paraqet probleme më të mëdha dhe të vazhdueshme në këtë periudhë është e këshillueshme që të vizitoni një doktor.

Servete Dërguli

A e mendon vallë?

Tryezë e shtruar plot…
Të pret në mes të dhomës.

Me njëmijë zijafete,
Të përshëndesin shërbëtorët.

Dyert… - pa trokitur…
Kanatet, për - ty, hapin… njëri pas tjetrit.

Rreth teje gjithçka rrotullohet…
E pika vështrimi, me përbuzje, mbi ta hedh ti.

E ka - pa qiellin… thua.
Kjo botë - është' imja.

Me të…bëj çfarë të dua.
S'ma ndien për asgjë…

Dhe shtrëngohesh foort…
Pas kësaj bote gënjështare.

Botë që përkëdhel me ledhatime.
Toruan… ta merr për fare.

Dhe dergjesh, - shkrriqesh, - shkaravitesh.
S'ta ndien për as-një gjë.

Perandoria që ti ke ngritur.
S'do shembet asnjëherë…

Por'… Oh!. .. Ç'të ndodhi?
Vallë… forcën ku e humbe?

Gjithë kjo perandori,
S'të mbajti? U lëkunde!!?

E-h , o i ngrati ti,
S'të erdhi keq për vete!!?

Çfarë nga pasuria,
Do të t' shpëtojë në jetë të jetëve?

Ç'i bëre shpirtit tënd?
Sa lirë atë e shite!

Ç'i bëre vetes tënde,
Pas shpinës, thikën fute:…

Kjo jetë është e përkohëshme
S'e mësove o i ngratë?

E gjithë pasuria.
Të lë me shpirtin thatë.

Dhe qeshet djallëzorja.
Me shpirtin tënd të ngratë.

E tallet hi,- hi, -hi.
Me ty… sa të mundet.

Ndaj… shpejto hapat,
Kthe rrugë sa s'është vonë,

E, Paqen të kërkosh,
Që shpirtin të shpëtosh.

PROGRESI
BOTIME

Arsyeja dhe Filozofia

I RI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË RINJ

SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: revistaetika@progresibotime.com
KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848
MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245